



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca
Komunikimi”**

ofruar nga

Kolegji Universitar “BEDËR”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Diana KALAJA

Dr. Ilda KASHAMI

Shtator 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” ofruar nga Kolegji
Universitar “Bedër”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Komunikimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.286, datë 06.04.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr.339, datë 06.07.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr.4, datë 28.02.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr. 28, datë 12.04.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023: 19 PAE/5 PAK Viti akademik 2023-2024: 12 PAE/4 PAK Viti akademik 2024-2025: 7 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023: 6 studentë Në proces riorganizimi
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca komunikimi” i ofruar nga Kolegjit Universitar BEDËR (KU BEDËR) përfaqëson një iniciativë në përputhje me kërkesat e arsimit të lartë. Akti zyrtar i hapjes/licencimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011. Ndërsa Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013. Sipas Vendimit Nr. 28, datë 12.04.2019, Bordi i Akreditimit, i Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ka miratuar akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”. Njësia bazë për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave të Komunikimit. Programi zgjat 3 vite/6 semestra dhe ka 180 kredite (ECTS).

Objektivi kryesor i këtij programi është pajisja e studentëve me njohuritë dhe informacionin e duhur në fushën e komunikimit, si dhe në disiplinat humane që e mbështesin atë. Kjo arrihet duke inkurajuar mendimin kritik, inovacionin dhe aspiratën për të arritur sukses si brenda ashtu edhe përtej institucionit, duke u dhënë mundësi studentëve të aplikojnë vlerat dhe informacionet e fituar në çdo aspekt të karrierës së tyre.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca komunikimi” është një nga programet më të hershme të këtij universiteti dhe është krijuar si një shtysë për ti dhënë hov zhvillimeve të reja të lidhura me profesionin e gazetarisë duke ju përshtatur nevojave të kohës. Programi i ka shërbyer afrimit më profesionin e gazetarit dhe specialistët të medias të një numri të gjerë studentësh, të cilët kanë zgjedhur, të thellojnë njohuritë e tyre në studimet e nivelit Master, krahas edhe vijimit të punës në mediat e ndryshme.

KU “Bedër” ka thelluar bashkëpunimin me kompanitë që veprojnë në biznesin mediatik në vend, si edhe bashkëpunimin nëpërmjet projekteve ndërkombëtare me universitete të huaja. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” është një iniciativë e vlefshme që promovon një mësimdhënie cilësore, përgatit studentët për sfidat e tregut të punës dhe kontribuon në zhvillimin e një force punëtore të kualifikuar në sektorët e komunikimit dhe marrëdhënieve publike.

Me kalimin e viteve, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, përgjegjës për këtë program studimi, duke vlerësuar ecurinë e kurrikulës dhe pas një analize të thelluar të tregut të punës ka kërkuar edhe riorganizimin e kurrikulës së programit, duke i vënë theksin tek disa elementë të tjerë praktikë. Programi është riorganizuar në “Gazetari dhe komunikim multimedial”

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për realizimin e vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Shkenca komunikimi” të Kolegjit Universitar “BEDËR”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u njoh fillimisht me bazën dokumentare të përcjellë nga institucioni pranë ASCAL. Aty përfshiheshin plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloret e programit të studimit, informacione mbi strukturat mbështetëse, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione për realizimin e praktikave mësimore, marrëveshje dhe projekte në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, udhëzues dhe mjaft evidenca të tjera mbështetëse, të cilat ofronin një pamje të qartë mbi organizimin dhe menaxhimin e programit.

Në datat 26 dhe 27 mars 2025, grupi zhvilloi takime sipas një agjende të koordinuar nga ASCAL me institucionin, të cilat ishin planifikuar paraprakisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Dr. Diana Kalaja dhe Prof. Asoc. Dr. Ilda Kashami. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Gjatë takimeve në institucion, GVJ bisedoi me personelin akademik, drejtuesit dhe studentët, si edhe përfaqësues të zyrave të ndryshme brenda Kolegjit Universitar “Bedër” duke mbledhur informacione të rëndësishme rreth praktikave të mësimdhënies, metodologjive të vlerësimit dhe kritereve të parashikuara në standardet e formatit të raportit për vlerësimin e jashtëm. Takimet dhanë një informacion parësor plotësues dhe të drejtpërdrejtë mbi ecurinë, rezultatet dhe sfidat me të cilat përballen studentët dhe pedagogët, si dhe mbi eficiencën e metodave të mësimdhënies të aplikuara.

Pas marrjes së informacionit dokumentar dhe realizimit të takimeve, GVJ analizoi me kujdes gjithë bazën dokumentare dhe informacionin e grupuar, duke i përdorur edhe si referenca në hartimin e një raport të detajuar. Ky raport përfshin një analizë të gjitha standardeve dhe kritereve të vlerësimit të programit, duke u siguruar që secili aspekt të jetë vlerësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Një element kyç i raportit është analiza SWOT e programit, e cila identifikon pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që ndër lidhen me zbatimin e tij. Raporti paraqet një vështrim të kujdesshëm mbi performancën e programit të studimit dhe ofron një bazë për rekomandimet e mëtejshme, duke u fokusuar në strategjitë që do të rrisin cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen profesionale të studentëve.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 28, datë 12.04.2019 janë:

- a. Të shikohet mundësia e rritjes së pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe projekte të BE-së, veçanërisht në projekte universitare dhe shkëmbimi të stafit dhe të studentëve;
- b. Të vijojë puna e nisur me plotësimin e literaturës në shqip.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- a. Pjesëmarrjen gjithnjë e më të madhe në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor, të BE-së, dhe sidomos në projekte universitare ka qenë një ndër objektivat themelore të universitetit. Pas daljes së vendimit të Bordit të Akreditimit, institucioni KU "Bedër" ka hartuar një plan veprimi për përmbushjen e këtij rekomandimi. Duke filluar që prej vitit 2019 është intensifikuar puna në pjesëmarrjen e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare siç janë ato të Erasmus +. Dokumenti mbi pjesëmarrjen e studenteve në programe shkëmbimi jep një pasqyrë të lëvizjes së studentëve në të tilla programe.

Dy marrëveshje në kuadër të këtyre programeve janë për tu evidentuar: si ajo me "Pontifical University of Salamanca" në kuadër të Erasmus+ KA171 dhe marrëveshja me "Universitatea de vest din Timisoara, Faculty of Sciences Political, Philosophy and Communication Sciences".

Gjithashtu, studentët kanë qenë edhe pjesëmarrës në projektet e ofruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, nëpërmjet USAID dhe Ambasadës amerikane si SUSI dhe UGrad.

Edhe stafi akademik, mbështetur në marrëveshjet e realizuara ka marrë pjesë në programe shkëmbimi në projekte të COST dhe Erasmus +.

- b. Në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias (ISHM), KU "Bedër" ka siguruar një fond të mirë librash si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja. Kjo për faktin se ISHM ka një praktikë të mirë të përkthimit dhe botimit të literaturës lidhur me median dhe sfidat që ajo paraqet. Janë 20 tituj që i janë dhuruar KU "Bedër" dhe ndër to përfshihen subjekte të lidhur me zhvillimet më të fundit në media ai ato të lidhura me Inteligjencën Artificiale, rrjetet sociale, ChatGPT, edukimin mediatik në përditshmëri, si edhe libra të lidhur me televizionin, kulturën, gazetarinë në demokraci apo historia e medias.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Komunikimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë në KU “Bedër”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por ruan vlerat kulturore kombëtare është në përputhje me politikat dhe interesat kombëtare. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”, ofrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Kolegjit Universitar “Bedër”. GVJ vë në dukje se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë elementë si: misioni, niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj. Bazuar në <i>Evidencën 1</i> dhe <i>Evidencën 2</i> drejtimit prioritar të programit janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e KU “Bedër” <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca 2. Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar Bedër</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”, është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke synuar formimin e specialistëve të cilët të mund t’i shërbejnë më së miri interesave të vendit. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program. <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca 40. Plani Strategjik Institucional KU Bedër 2018-2023 dhe 2024-2028</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Bachelor në Shkenca Komunikim”</i>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”, është i hartuar me një kornizë të plotë misioni dhe objektivash të cilat janë në harmoni edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit 2018/2023. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësive kryesore dhe njësive bazë që e ofron këtë program. <i>Evidenca 40. Plani Strategjik Institucional KU Bedër 2018-2023 dhe 2024-2028</i> <i>Evidenca 1. Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Kolegji Universitar ‘Bedër’ operon në tregun shqiptar që në vitin 2011 i organizuar në 2 (dy) fakultete dhe 7 (shtatë) departamente, zotëron kapacitetet për të ofruar këtë program studimi. Angazhimi i këtij Institucioni në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare gjithashtu është një faktor që ndikon pozitivisht në krijimin e kapaciteteve për ofrimin e këtij programi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua mbi mundësitë dhe kapacitetet për ofrimin e programit si dhe angazhimin e institucionit në trajnimin dhe zhvillimin e stafit për këtë program studimi. <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.7: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.</i> <i>Evidenca nr. 15: CV-të e Stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.</i> <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.6, Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit.</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në kurrikul programit të studimit i është dhënë një qasje vizionare në përgatitjen e ekspertëve në fushën e komunikimit, kuadër ky i cili kompletohet gjithashtu me ofrimin nga ky institucion të Programit të Studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, si edhe programin profesional, dy vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn grafik”. <i>Evidenca nr. 5 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i>


udhëzimeve kombëtare e evropiane.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi", është i hartuar me një kornizë të plotë misioni dhe objektivash dhe ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Universitar "Bedër".</i> <i>GVJ vë në dukje se ky program studimi mbështetet në elemente të cilët janë komponentë të rëndësishëm në realizimin e këtij programi dhe ruajtjen e cilësisë si: misioni, niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj.</i> <i>GVJ vlerëson se ky program është në harmoni edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit 2018-2023. Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi", është hartuar për të plotësuar kërkesat e tregut të punës për ekspertë në fushën e komunikimit dhe multimedias në sektorë të ndryshëm të punës në të cilët teknologjia moderne është zhvilluar me ritme të shpejta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Gjatë vizitës në KU "Bedër" u vu re se Institucioni ka krijuar një strukturë funksionale dhe të mirëorganizuar që siguron bashkëpunim efektiv ndërmjet njësive dhe personelit. Përgjegjësitë janë të ndara qartë, çka ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe në mbarëvajtjen e programit. Vërehet një kulturë e analizës së vazhdueshme të punës dhe përmirësimit të saj, duke garantuar që detyrat të përmbushen në përputhje me objektivat institucionale. Bashkëpunimi ndërmjet njësive është i strukturuar dhe mbështetet nga mekanizma të qartë koordinimi dhe monitorimi. <i>Evidenca nr. 23: Vendimi i këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë</i> <i>Evidenca nr. 73: Vendimi i këshillit të Departamentit për Përcaktimin e përfaqësuesit pranë NJSBC-së</i> <i>Evidenca nr. 4: Rregullorja mbi Organizimin Akademik</i>

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e partneriteteve me institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të sektorit privat. Këto bashkëpunime kontribuojnë në pasurimin e përvojës akademike dhe formuese të studentëve, duke u krijuar atyre mundësi për praktikë, shkëmbime akademike dhe zhvillim profesional. Marrëdhëniet me partnerët strategjikë janë të dokumentuara dhe në funksion të objektivave të programit studimor. Institucioni ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me fokus të veçantë në partneritetet me universitete në Rumani dhe Spanjë. Këto bashkëpunime janë konkretizuar përmes marrëveshjeve për shkëmbime akademike, projekte të përbashkëta dhe mundësi praktike për studentët. <i>Evidenca nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) dhe mobiliteti për staf dhe studentë me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit - Marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me University of Timisoara; University of Salamanca</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë për të garantuar zbatimin cilësor të programit të studimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të posaçme me institucione partnere, institute kërkimore dhe kompani të profilit përkatës. Këto marrëveshje mbështesin realizimin e praktikave profesionale dhe të stazhit, duke i ofruar studentëve një përvojë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës dhe duke përforcuar kompetencat praktike të fituara gjatë studimeve. Bashkëpunimet janë të strukturuar dhe të përshtatura sipas nevojave të programit. Mund të përmendim këtu “Memorandumet e mirëkuptimit për bashkëpunimin e ndërsjellë” midis: • “KU Bedër” dhe “New Media Communication” • “KU Bedër” dhe “New Media Digital” • “KU Bedër” dhe “Iceberg Communication” Në këtë proces luajnë rol të rëndësishëm edhe Zyra e të Diplomuarve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës, të cilat ndihmojnë në koordinimin e këtyre marrëveshjeve dhe në përafrimin e përvojës akademike me kërkesat e tregut të punës. Këto struktura sigurojnë që studentët të kenë qasje të drejtpërdrejtë në mundësi praktike cilësore dhe të orientohen drejt zhvillimit të qëndrueshëm profesional. <i>Evidenca nr. 60: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2023-2024</i>



	<i>Evidenca nr. 49: Procedura e Praktikës Profesionale</i> <i>Evidenca nr. 35: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.</i> <i>Evidenca nr. 26: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fusha të Ndryshme</i>			
riteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit zhvillon në mënyrë periodike raporte analitike që vlerësojnë përfitimet konkrete nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme. Këto raporte ndihmojnë në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të zbatimit të programit, duke identifikuar aspekte të suksesshme dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje ose optimizim. Analiza e të dhënave të grumbulluara kontribuon në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimeve dhe në përshtatjen më të mirë të programit me nevojat aktuale akademike dhe profesionale të studentëve. <i>Evidenca nr. 55: Raport i Zyrës së planifikimit të karrierës</i> <i>Evidenca nr. 56: Raport i zyrës së të diplomuarve</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur një strukturë të qartë dhe funksionale për hartimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e programit të studimit, duke garantuar ndarje të mirëorganizuar të përgjegjësi dhe një bashkëpunim efektiv ndërmjet njësive të brendshme. Bashkëpunimet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e tregut të punës, përbëjnë një komponent të rëndësishëm për arritjen e objektivave të procesit mësimor dhe formues.</i> <i>Përmes marrëveshjeve me institucione, institute kërkimore dhe kompani të fushës përkatëse, institucioni siguron zhvillimin e praktikave profesionale, klinike dhe të stazhit, duke përfshirë në këtë proces edhe Zyrën e të Diplomuarve dhe Zyrën e Planifikimit të Karrierës. Këto bashkëpunime jo vetëm rrisin përgatitjen praktike të studentëve, por edhe forcojnë lidhjen mes formimit akademik dhe tregut të punës.</i> <i>Gjithashtu, njësia përgjegjëse për programin ndjek një praktikë të rregullt të hartimit të raporteve analitike, të cilat vlerësojnë rezultatet e bashkëpunimeve dhe ndikimin e tyre në realizimin cilësor të programit. Këto analiza shërbejnë si bazë për përmirësime të vazhdueshme dhe vendimmarrje të informuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” është i hartuar në përputhje me objektivat e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Bedër”, të përcaktuar në planin strategjik 2024-2028. Ky program studimit është i shpërndarë në vite dhe semestra si dhe i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse duke respektuar legjislacionin vendës në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Kjo ndarje është në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzim nr.15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i> <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri,	Gjatë vizitës së zhvilluar në KU “Bedër”, GVJ konstatoi se Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” është i dizajnuar për të ofruar formim të thelluar dhe të gjithanshëm në një gamë të gjerë profesionesh dhe specialitetesh, duke përfshirë fushat e komunikimit masiv, gazetarisë, marketingut dhe menaxhimit të mediave. Ky program synon zhvillimin e njohurive të avancuara në teoritë dhe parimet e komunikimit, duke mundësuar një kuptim kritik dhe të thelluar të dinamikave dhe mjeteve të komunikimit modern. Studentët zhvillojnë aftësi dhe kompetenca të përparura që i mundësojnë atyre të adresojnë dhe zgjidhin probleme komplekse dhe të

aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	paparashikueshme në fushat profesionale të mediave, komunikimit dhe publicitetit. Ky formim përgatit studentët për të kontribuar në mënyrë efektive në industrinë e komunikimit, duke i aftësuar ata për të përballuar sfidat e komunikimit në mjedise të ndryshme profesionale. <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion vërehet se janë të specifikuara kategoritë formuese me lëndët përkatëse. Çdo lëndë dhe modul është i përcaktuar me ngarkesën përkatëse në kredite, duke ndihmuar në krijimin e një kuadri akademik të balancuar dhe të qartë. Ky organizim i mundëson studentëve të kuptojnë qartë kërkesat e programit dhe t'i menaxhojnë më mirë oraret e tyre të studimit, duke siguruar një zhvillim të plotë të njohurive dhe aftësive përkatëse në fushën e studimit. Kjo strukturë gjithashtu ndihmon në përputhshmërinë e programit me standardet ndërkombëtare dhe lehtëson kalimin e lëndëve nga një institucion në tjetër, në kuadër të Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe për detyrimet përmbyllëse. Praktika profesionale me kod COM 307 është e vlerësuar me 5 ECTS, duke mundësuar që studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe të aplikojnë njohuritë e fituara gjatë studimeve. Po ashtu, punimi i diplomës me kod COM 398, që ka një vlerë prej 6 ECTS, është një element kyç i programit, duke u mundësuar studentëve të realizojnë një kërkim të thelluar dhe të aplikojnë teoritë dhe metodat e studiuar për të adresuar probleme të avancuara në fushën e komunikimit. Ky organizim siguron që studentët të kenë një përvojë të balancuar akademike dhe profesionale, duke përmbyllur kërkesat e programit dhe duke iu mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi të avancuara për të hyrë në tregun e punës. <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca Shtojca, Tabela nr.9 -Plani mesimor</i>

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”, ka një përputhshmëri prej 70% me programet e tjera të studimit Bachelor që ofrohen në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtin emër. Kjo siguron një përmbajtje të ngjashme në nivel, duke garantuar që studentët të përfitojnë njohuri dhe aftësi të ngjashme, pavarësisht nga variacionet në detajet e lëndëve ose qasjet pedagogjike.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Ky program studimit është shoqëruar me kodin përkatës 63BA0320S (Fusha III, Shkenca Sociale, Gazetari dhe Informim) sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, VKM nr. 310, datë 11.05.2022, duke siguruar që të gjitha programet e ofruara të jenë të standardizuara dhe të njohura në nivel kombëtar. Për më tepër, kodifikimi i lëndëve të programit është realizuar në përputhje me këtë sistem, duke mundësuar një organizim të qartë dhe transparent të të gjitha moduleve dhe kurseve të përfshira. <i>Evidenca nr. 18: VKM 310, datë 11.5.2022 për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA
Konkluzione	Programi i studimit është strukturuar në përputhje me kërkesat dhe standardet akademike të vendosura nga legjislacioni



	<i>vendas dhe Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët dhe modulet janë organizuar në mënyrë të qartë, duke siguruar që çdo komponent të ketë ngarkesën e duhur në kredite dhe të kontribuoni në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për studentët. Praktikën profesionale dhe punimet e diplomës janë të kodifikuara dhe të vlerësuara si aktivitete të rëndësishme që lidhen ngushtë me përvojën e punës dhe kërkesat e tregut.</i> <i>Përputhshmëria prej 70% e programit të studimit me programet e tjera të ngjashme siguron një nivel të lartë të koherencës dhe standardizimit brenda fushës së studimit. Programi është gjithashtu i kodifikuar dhe i strukturuar në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me klasifikimet dhe kërkesat e ligjshme.</i> <i>Në përgjithësi, ky program i studimit ofron një bazë të fortë akademike dhe praktike, duke siguruar që studentët të jenë të pajisur me njohuri dhe aftësi të avancuara, të cilat i mundësojnë atyre të përballen me sfida të ndryshme profesionale dhe akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim. Departamenti i Shkencave të Komunikimit është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton i përbërë nga këto departamente: • Departamenti i Shkencave të Komunikimit • Departamenti i Drejtësisë • Departamenti i Shkencave Islame • Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze

Personeli i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë përbëhet nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe personeli administrativ.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, që është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” përbëhet nga 11 anëtare (PAE) ndër ta: 3 me gradën Doktor, 5 anëtare (PAK) dhe një personel ndihmës akademik Ky staf angazhohet në procesin mësimor dhe të kërkimit shkencor. Stafi akademik përmbush detyrimet ligjore për pjesën e mësimdhënies, gjë e cila vërehet nga ngarkesa mësimore që ata marrin në KUB. Gjithashtu ata janë të angazhuar edhe në procesin e kërkimit shkencor.

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ku bën pjesë programi i studimit BSC në “Shkenca Komunikimi” ka në përbërjen e tij për vitin akademik 2024-2025 staf si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	2024-2025	
	PAE	PAK
Prof.dr	1	2
Prof.Asc.Dr	6	-
Dr/Doc	9	9
Msc	20	11
Totali	36	22

Departamenti i Shkencave të Komunikimit për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Asc.Dr	-	2	-	2	1	-
Dr/Doc	5	1	3	-	3	1
Msc	7	4	7	5	8	3
Totali	12	7	10	7	11	4

Shtojca 1. Tabelat përmbledhëse për programin (Tabela 1 dhe 2)

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e

Nga evidencat e vëna na dispozicion GJV vëren se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ në mbështetje të

përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	realizimit të praktikave mësimore, laboratorike. Ky angazhim siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor praktik dhe garanton mbështetjen e nevojshme teknike e organizative për zhvillimin e moduleve që kërkojnë ndërveprim të drejtpërdrejtë të studentëve me mjedise laboratorike apo profesionale. Një rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentëve luan edhe këshilltari akademik, i cili ka për detyrë të orientojë dhe ndihmojë ata në zgjedhjen e lëndëve, ndjekjen e progresit akademik, përmbushjen e praktikave dhe përgatitjen e punimeve përmbyllëse. Këshilltari shërben si një urë lidhëse ndërmjet studentit dhe strukturave akademike, duke ofruar udhëzime të personalizuar për të siguruar përparim të qëndrueshëm dhe përmbushje të suksesshme të programit të studimit. <i>Evidenca Shtojca, Tabela nr. 7- Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka caktuar një koordinitor të programit, i cili mbart përgjegjësinë për ndjekjen e ecurisë, zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit në përputhje me objektivat e tij akademike dhe profesionale. Koordinatori luan një rol kyç në organizimin dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, duke siguruar që ato të jenë të integruara në mënyrë efektive në kurrikul dhe të realizohen në bashkëpunim me strukturat përkatëse brenda dhe jashtë institucionit. Ky funksion siguron koherencë, cilësi dhe përputhje të programit me standardet e përcaktuara ligjore dhe akademike. <i>Evidenca nr. 22: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca nr. 6: Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Parë</i>
Konkluzione	<i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit funksionon në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke siguruar një strukturë të qartë organizative dhe mbështetëse. Ajo angazhon personel ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike dhe, sipas rastit, klinike, duke garantuar zhvillimin cilësor të komponentëve praktikë të programit.</i> <i>Në mbështetje të orientimit dhe zhvillimit akademik të studentëve, është funksional roli i këshilltarit akademik, i cili siguron ndihmë të vazhdueshme për zgjedhjet studimore dhe ndjekjen e progresit individual të studentëve. Kjo ndihmon në</i>

	<i>personalizimin e përvojës akademike dhe në rritjen e suksesit të studentëve në përmbushjen e objektivave të studimit.</i> <i>Gjithashtu, është i përcaktuar koordinatori i programit, që mbikëqyr zbatimin, ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Ky rol është thelbësor për sigurimin e cilësisë, përputhshmërisë me objektivat e programit dhe për organizimin e praktikave profesionale në bashkëpunim me aktorë të jashtëm dhe njësitë e brendshme.</i> <i>Në tërësi, struktura menaxhuese dhe mbështetëse e programit funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase, duke garantuar zbatimin e standardeve akademike dhe përmbushjen e objektivave institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve që ofron. Këto informacione janë të dokumentuara në mënyrë të qartë dhe janë lehtësisht të aksesueshme për stafin akademik, administrativ dhe studentët. Njësia siguron që të gjitha aspektet e programit përfshirë objektivat, rezultatet e të nxënit, kreditet sipas ECTS, përshkrimet e lëndëve dhe metodologjinë e mësimdhënies, të jenë të harmonizuara me kornizën ligjore dhe standardet kombëtare të arsimit të lartë. Kjo transparencë dhe organizim ndihmojnë në administrimin e qëndrueshëm të programeve dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo gjë gjithashtu konstatohet në rregulloret dhe në Statutin e këtij Institucioni. <i>Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 5: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i>

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë disponon informacionin e plotë dhe të përditësuar për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve që ofron. Programi i studimit përmban planin mësimor, i cili përfshin ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të çdo lënde apo moduli, si dhe ndarjen e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, në përputhje me standardet e ECTS. Këto të dhëna janë të dokumentuara qartë dhe lehtë të aksesueshme për stafin dhe studentët, duke mundësuar një menaxhim efikas të procesit mësimor dhe mbështetje të vazhdueshme në përmbushjen e objektivave akademike të programit. Konkretisht kjo ndarje vijon: 5-10 % pjesëmarrja; 10-20 % plotësimi i detyrave laboratorike dhe të kursit; 20-30 % testimet gjatë vitit; 40-50 % provimi përfundimtar; Gjithashtu, për secilën lëndë janë të hartuara syllabuset përkatëse, të cilat përfshijnë qëllimet, rezultatet e të nxënit, përmbajtjen tematike, metodologjinë e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit dhe literaturën bazë. Këto dokumente garantojnë transparencë, udhëheqje të qartë për stafin pedagogjik dhe orientim për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. <i>Evidenca nr. 82: Udhëzim për Ngarkesën Mësimore</i> <i>Evidenca nr. 79: Shembull sylabusi</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e pranimit, përfshirë notën mesatare si një nga elementët kyç, janë miratuar nga Senati Akademik dhe janë të përfshira në Guidën e Studentit, e cila shërben si udhëzues për kandidatët dhe studentët. Kriteret publikohen në portalin U-Albania, i cili është i aksesueshëm nga Institucionet. Kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%. Të gjitha informacionet janë të publikuara në website-n e institucionit: www.beder.edu.al Guida e Studentit përfshin gjithashtu informacion mbi procedurat e transferimit nga institucione të tjera, si dhe ekuivalentimin e krediteve të fituara në programe të ndryshme studimi. Kjo qasje garanton një proces të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të drejtë për të gjithë aplikuesit dhe studentët, duke u siguruar atyre që janë të informuar dhe të mbështetur për të realizuar objektivat e tyre akademike në përputhje me kërkesat institucionale dhe ligjore.

	<i>Evidenca nr. 82: Udhëzim për Ngarkesën Mësimore</i> <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca nr. 20: Guida e Studentit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion GVJ-ja konstaton se programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" është i pajisur me një plan lëndor në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për secilën nga lëndët GVJ-ja pati mundësi të njëjhej me syllabuset përkatëse si dhe format e zhvillimit të praktikës së studentëve. Syllabuset e vëna në dispozicion janë në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Syllabuset përmbajnë informacion të detajuar për përmbajtjen e lëndëve, objektivat e të nxënësve, metodat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit dhe literaturën bazë. Gjithashtu, ato përfshijnë detaje për praktikat, seminarët, dhe orët e laboratorëve, duke specifikuar ngarkesën mësimore dhe ndarjen e orëve brenda dhe jashtë auditorit. Komponentët formues të programit, përfshirë aktivitetet praktike dhe ato jashtë auditorit, janë të përfshira dhe të përcaktuara qartë në përputhje me formatet dhe standardet e miratuara nga institucionet përkatëse. <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca nr. 77: Syllabus-et e lëndëve të programit</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë takimit me stafin akademik të departamentit GVJ konstatohet se përmirësimi i programeve të studimit dhe përputhshmëria me ndryshimet e tregut është objekt përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, duke siguruar që ai të mbetet në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën përkatëse të studimit, kërkesat e tregut të punës dhe kërkesat ligjore. Kjo procedurë rregullohet përmes Politikës së KU "Bedër "Për përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit" Në fillim të çdo viti akademik, ndryshimet eventuale në programin e studimit shqyrtohen nga Departamenti përkatës, Fakulteti, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave nën Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senati Akademik dhe arkivohen në një dosje të plotë, që përmban dokumentacionin e të gjitha ndryshimeve dhe përditësimeve. Ky proces përmirësimi i vazhdueshëm siguron që programi të mbetet cilësor, i përditësuar dhe i përshtatshëm për nevojat e studentëve dhe për sfidat e reja të fushës akademike dhe profesionale.

	Evidenca nr. 65: Rregullorja e Funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit Evidenca nr. 72: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në KU "Bedër", u konstatua se ky program studimi është i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike, duke siguruar një përvojë të plotë dhe cilësore për studentët. Njësia përgjegjëse për programin e studimit dispononte gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e strukturës dhe përmbajtjes së programit, përfshirë planin mësimor, syllabuset, praktikat profesionale dhe orët e laboratorit. Këto informacione janë të dokumentuara dhe të disponueshme për studentët, për të garantuar një orientim të qartë dhe të plotë për çdo aspekt të studimeve. Në përputhje me standardet dhe politikat akademike, kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të miratuara nga Senati Akademik dhe janë të përfshira në Guidën e Studentit, duke siguruar një proces të drejtpërdrejtë dhe të barabartë për studentët dhe aplikantët. Ky dokument ofron një udhëzues të plotë për procedurat dhe kërkesat që lidhen me pranimin dhe kalimin e studentëve nga një program në tjetrin. Për më tepër, përmbajtja e programit të studimit është subjekt i një përditësimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm, i cili realizohet çdo vit akademik dhe i cili është miratuar dhe dokumentuar në përputhje me ndryshimet eventuale që mund të lindin në fushën akademike dhe profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale në programin e studimit janë të

veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	dizajnuara në mënyrë që të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 6 semestra me nga 30 ECTS secili. Kjo strukturë synon jo vetëm përgatitjen e studentëve për studime të mëtejshme në nivele të tjera akademike, por gjithashtu i përgatit ata për punësim në tregun e punës, duke i pajisur ata me njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën përkatëse. Ndarja e lëndëve dhe integrimi i praktikave profesionale janë të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës dhe kërkesat e institucioneve akademike, duke siguruar një program që ofron mundësi për zhvillim profesional dhe akademik të studentëve. <i>Evidenca nr. 49: Procedura e Praktikës Profesional</i> <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.10</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Lëndët dhe modulet, së bashku me shpërndarjen e tyre në vite dhe semestra, janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të arrihen rezultatet e pritshme të të nxënit. Plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 6 semestra me nga 30 kredite ECTS ose 750 orë mësimore secili, ku një ECTS është e barabartë me $750/30 = 25$ orë mësimore. Programi i studimit është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vlerësimi në kredite dhe orët mësimore për secilën lëndë janë të përcaktuara qartë për të siguruar një balancë mes mësimdhënies teorike dhe atyre praktike <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.10</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë të projektuar në përputhje me profilin e programit të studimit, duke siguruar që studentët të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të kërkuara për të përmbushur kërkesat e industrisë dhe të tregut të punës. Ky program ofron një balancë të mirë mes njohurive teorike dhe praktikës, duke i mundësuar studentëve të aplikojnë atë që mësojnë në kushte reale të praktikës profesionale, seminareve dhe aktiviteteve të tjera formuese. Për më tepër, strukturat dhe lëndët e programit janë të përshtatshme dhe të përafërta me ato të programeve ndërkombëtare të ngjashme, duke siguruar një përputhshmëri me praktikën më të mira dhe standardet globale. Kjo mundëson që studentët të jenë të përgatitur për tregun global të punës dhe t'i japë atyre mundësi për të konkurruar në nivel ndërkombëtar. <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.10</i>

	Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi është i organizuar në përputhje të plotë me ndarjen e veprimtarive formuese sipas legjislacionit në fuqi. Lëndët e përzgjedhura për këtë program mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve mundësinë për mobilitete si dhe mundësi punësimi për studentët me anë të marrëveshjeve që zotëron institucioni. Në këtë program studimi i jepet një vëmendje e veçantë praktikës bazuar në qasjen dhe në konceptimin e këtij programi. Ky integrim ndihmon studentët të përvetësojnë aftësitë dhe njohuritë që janë të nevojshme për t'u përballur me sfidat profesionale në fushën e komunikimit dhe t'i aplikojnë ato në kushte reale pune. Evidenca nr. 27: Lista e praktikave profesionale të studentëve Evidenca nr. 26: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fusha të Ndryshme
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në syllabuset që u vunë në dispozicion të GJVJ-së lëndët e ofruara në këtë program studimi janë të organizuara në literaturë të detyruar dhe literaturë të rekomanduar e cila i përket viteve të fundit. Përditësimi i syllabus-eve përfshin rishikimin e përmbajtjes tematike, modernizimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe përfshirjen e literaturës bazë dhe ndihmëse të përditësuar, e cila pasqyron zhvillimet e fundit akademike dhe profesionale në fushën përkatëse. Ky proces përmirësimi bazohet në analizën e vazhdueshme të rezultateve të të nxënësve, në sugjerimet e stafit akademik dhe shpesh në konsultimet me aktorët e tregut të punës, duke siguruar që programi të jetë i orientuar drejt praktikës dhe i dobishëm për integrimin profesional të studentëve. Evidenca nr. 36: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e sylabuseve Evidenca nr. 77: Syllabus-et e lëndëve të programit Evidenca nr. 83: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" është i përpiluar dhe i organizuar në mënyrë të tillë që garanton përfitimin e dijeve teorike dhe praktike për studentët e ciklit të dytë master profesional. Programi përfshin lëndë teorike dhe praktike që mbulojnë aspekte kyçe të fushës së komunikimit, duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë njohuri të thelluara

	akademike, aftësi analitike, dhe kompetenca praktike të aplikueshme në situata reale pune. Përmes një strukture të balancuar ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik, programi synon të pajisë studentët me një profil profesional dhe akademik të plotësuar, të përshtatshëm si për tregun e punës ashtu edhe për vazhdimin e studimeve në cikle më të larta. Kompetencat që përfitohen përfshijnë aftësi të komunikimit efektiv, mendim kritik, zgjidhje problemesh, si dhe përdorim të teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe medias – të gjitha këto në përputhje me nevojat aktuale të sektorit të komunikimit dhe standardet e arsimit të lartë. <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit është konceptuar në mënyrë të tillë që të krijojë një bazë të fortë akademike dhe profesionale, e cila u mundëson studentëve si vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë (Master), ashtu edhe punësimin në sektorë të ndryshëm që lidhen me fushën e komunikimit. Struktura e programit, përmbajtja e lëndëve, dhe përfshirja e praktikave profesionale janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë trajnimin për aftësi që kërkohen aktualisht në industri si: komunikimi mediatik, marrëdhëniet me publikun (PR), komunikimi institucional, gazetaria, menaxhimi i mediave dhe komunikimi dixhital. Programi është ndërtuar mbi një qasje kompetencash, që siguron zhvillimin e aftësive të transferueshme si puna në grup, menaxhimi i informacionit, të menduarit kritik dhe komunikimi ndërpersonal – të cilat janë thelbësore si për punësim të menjëhershëm, ashtu edhe për ndjekjen e studimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. Kjo i jep programit fleksibilitet dhe studentëve avantazh në karrierën e tyre akademike apo profesionale. <i>Evidenca nr. 75: Studim Tregu i Departamentit</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" është projektuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ai ofron një strukturë të qartë dhe të balancuar ndërmjet formimit teorik dhe praktik, duke mundësuar përfundimin e dijeve,</i>

	<i>aftësive dhe kompetencave të synuara për një formim të plotë akademik dhe profesional.</i> <i>Përmbajtja e lëndëve, shpërndarja në semestra, ngarkesa në kredite dhe praktikat profesionale janë të konceptuara në funksion të arritjes së objektivave formues dhe përgatitjes së studentëve për punësim të menjëhershëm ose vazhdim të studimeve në cikle më të avancuara. Gjithashtu, raporti teori-praktikë dhe ndarja sipas veprimtarive formuese përputhet me programet homologe në nivel ndërkombëtar, duke rritur mundësitë për mobilitet dhe transferim studimesh.</i> <i>Programi përditësohet rregullisht përmes rishikimit të syllabuseve, duke përfshirë literaturën më të fundit dhe duke reflektuar zhvillimet në tregun e punës. Kjo tregon një angazhim të vazhdueshëm për cilësi akademike, punësueshmëri të lartë dhe adaptueshmëri ndaj sfidave bashkëkohore në fushën e komunikimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit dhe për ta përshtatur atë me kërkesat në ndryshim të tregut të punës, njësia përgjegjëse angazhohet në konsultime të rregullta me institucione partnere, ish-studentë të diplomuar, si dhe me aktorë nga tregu i punës. Këto konsultime ndodhin si gjatë hartimit fillestar të programit, ashtu edhe gjatë zbatimit dhe përditësimit të tij, për të reflektuar zhvillimet profesionale dhe teknologjike në fushën e komunikimit. Propozimet dhe sugjerimet e këtyre aktorëve ndikojnë në përzgjedhjen e lëndëve, përmbajtjen e tyre, zhvillimin e praktikave profesionale dhe përcaktimin e aftësive që programi duhet të zhvillojë te studentët. Si rrjedhojë e këtyre konsultimeve, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, riorganizoi programin e studimit Bachelor në

	“Shkenca Komunikimi” dhe në Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim Multimedial”. <i>Evidenca nr. 75: Studim Tregu i Departamentit</i> <i>Evidenca nr. 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) dhe mobiliteti për staf dhe studentë me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit - Marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me University of Timisoara; University of Salamanca</i> <i>Evidenca nr. 35: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale -Memorandumi i bashkëpunimit i firmosur me kompanitë “Iceberg Communication”, “New Media Communication” dhe “NewMedia Digital”</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët, zyrën alumni dhe koordinatorin e programit të studimit GJVJ-ja u informua se institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët duke ngritur struktura si fokus grupe, dhe duke zgjedhur një përfaqësues i cili qëndron në kontakt të vazhdueshëm me institucionin me qëllim funksionimin dhe përmirësimin e punës në programin e studimit. Institucioni promovon një kulturë përfshirëse dhe bashkëpunuese, ku studentët aktivë dhe të diplomuar, si dhe strukturat e tyre përfaqësuese (si këshillat studentorë), përfshihen në mënyrë aktive në diskutimet dhe konsultimet që lidhen me përmirësimin e programit të studimit. Përmes takimeve periodike, pyetësorëve të vlerësimit, forumeve të hapura dhe feedback-ut të strukturuar, institucioni siguron që zëri i studentëve të dëgjohet dhe të merret në konsideratë në mënyrë efektive. Gjithashtu, kontaktet me studentët e diplomuar mbahen të vazhdueshme nëpërmjet Zyrës së të Diplomuarve dhe aktiviteteve të organizuara nga Zyra e Karrierës, të cilat ofrojnë informacion të vlefshëm për përshtatshmërinë e programit me realitetin profesional. Sugjerimet dhe reflektimet e tyre ndihmojnë në përmirësimin e strukturës, përmbajtjes dhe metodave mësimore të programit. Kjo qasje dypalëshe kontribuon në rritjen e cilësisë së programit dhe siguron që ai të mbetet i aktualizuar dhe i orientuar drejt nevojave të tregut të punës dhe të studentëve. <i>Evidenca nr. 12: Anketë Vlerësimi i Studentëve për Programin e Studimit</i>

	Evidenca nr. 11: Anketë Vlerësimi e Mendimit të Studentëve ndaj Institucionit Evidenca nr. 9: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcaktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës Evidenca nr. 74: Zgjedhjet e Këshillit Studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin, përditësimin dhe përshtatjen e përmbajtjes së programit, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit dhe nevojat e tregut të punës. Ky proces realizohet përmes bashkëpunimeve me rrjete profesionistësh, shoqata dhe organizata profesionale, si dhe me institucione publike dhe private që operojnë në fushën e medias, marrëdhënieve me publikun, marketingut dhe teknologjisë së informacionit. Konsultimi me këta aktorë sjell një input të vlefshëm profesional, që ndikon në rishikimin e syllabus-eve, përfshirjen e tematikave të reja bashkëkohore dhe integrimin e kompetencave që reflektojnë trendet aktuale të komunikimit dixhital dhe ndërpersonal. Kjo qasje ndihmon në ruajtjen e relevancës akademike dhe profesionale të programit dhe garanton që përmbajtja e tij të jetë në harmoni me praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Evidenca nr. 75: Studim Tregu i Departamentit Evidenca nr. 26: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fusha të Ndryshme
Konkluzione	Institucioni dhe njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" tregojnë një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin dhe përditësimin e programit në përputhje me zhvillimet e tregut të punës dhe kërkesat profesionale bashkëkohore. Përmes konsultimeve të rregullta me institucione partnere, studentë të diplomuar, strukturat studentore, si dhe me aktorë të fushës së komunikimit, programi përfiton nga sugjerime dhe praktika të cilat reflektohen në përmbajtje dhe organizim. Gjithashtu, bashkëpunimi me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike/private ndihmon në përshtatjen dinamike të lëndëve dhe metodologjisë së mësimdhënies, duke garantuar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe realitetin profesional. Kjo qasje kontribuon në rritjen e cilësisë, punësueshmërisë dhe mobilitetit akademik të studentëve.

	Si rezultat, programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" jo vetëm që ruan aktualitetin dhe vlerën akademike, por siguron edhe një formim të orientuar drejt praktikës, i cili i përgatit studentët për sfidat dhe kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit në "Shkenca Komunikimi" përfshin një larmi formash të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilat janë të konceptuara për të siguruar përvetësimin efektiv të njohurive dhe zhvillimin e kompetencave akademike e praktike të studentëve. Këto forma përfshijnë: leksione teorike, seminare interaktive, punë në laborator dhe media, detyra kursi dhe ese analitike, projekte individuale apo në grup, praktika profesionale dhe orë të hapura me pjesëmarrje të aktorëve të fushës. Kjo shumëllojshmëri metodash synon të përfshijë studentin në një proces aktiv të të nxënit, duke stimuluar të menduarit kritik, aftësitë analitike, kreativitetin dhe bashkëpunimin. Përfshirja e praktikave profesionale dhe e projekteve reale i ekspozon studentët ndaj situatave konkrete të fushës së komunikimit, duke përmirësuar gatishmërinë e tyre për tregun e punës. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 65: Rregullorja e Funkcionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit</i>

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit në “Shkenca Komunikimi” tregon një qasje të ndjeshme dhe të diferencuar ndaj larmisë së studentëve dhe nevojave të tyre të ndryshme mësimore. Ky staf respekton diversitetin në stilin e të nxënit, përgatitjen paraprake, interesat dhe sfidat individuale të studentëve, duke përdorur metoda dhe forma alternative të mësimdhënies që mbështesin gjithëpërfshirjen dhe maksimizojnë përvetësimin e dijes. Përveç leksioneve klasike, përdoren platforma digjitale, materiale multimediale (Google Classroom, sistemi BIS etj.), konsultime individuale, si dhe forma të ndryshme të angazhimit në punë praktike dhe diskutime. Gjithashtu, stafi është i disponueshëm për mbështetje akademike dhe orientim individual, duke kontribuar në ndërtimin e një ambienti të hapur dhe të përshtatshëm për zhvillimin personal dhe profesional të çdo studenti. Gjatë takimit me lektorët e programit të studimit u diskutua në lidhje me nevojat e studentëve dhe ishte evidente gatishmëria e stafit akademik për të përshtatur metodat e mësimdhënies me nevojat e studentëve. U diskutua në lidhje me shembuj konkretë dhe masat e marra nga lektorët për të lehtësuar mësimnxënien e studentëve. Kjo gjë u pranua edhe nga studentët në takimin me ta. <i>Evidenca nr. 14: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët</i> <i>Evidenca nr. 83: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i> <i>Evidenca nr. 84: Udhëzuesi për Mësimdhënien Inovative</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Me qëllim mbështetjen e personelit në zhvillim e kompetencave didaktike institucioni angazhohet aktivisht në mbështetje dhe zhvillim të kompetencave didaktike të personelit akademik, duke krijuar mundësi dhe resurse për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive mësimore dhe pedagogjike. Përmes kurseve të trajnimit, workshopeve, dhe seminarëve profesionale, institucioni ofron mundësi për personelin akademik që të përmirësojë metodat dhe teknikat e mësimdhënies, duke i ndihmuar ata të adaptohen me formatet më të reja dhe më të efektshme të të nxënit. Kjo qasje ka si qëllim përmirësimin e cilësisë akademike, duke ndihmuar që metodat e përdorura në mësimdhënie të jenë

	gjithmonë të përshtatura me kërkesat e studentëve dhe objektivat e programit. Evidenca nr. 28: Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2024
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në <i>Evidencën 15</i>, vërejmë se stafi akademik ka formimin e duhur për lëndët që lektron. Personeli akademik i angazhuar në Shkenca Komunikimi ka një nivel të lartë kompetence dhe aftësie për të shpjeguar njohuri dhe koncepte të avancuara në mënyra të qarta dhe të kuptueshme. Ata përdorin metoda të ndryshme mësimdhënës, duke u fokusuar në mësimdhënien interaktive dhe diskutimet me studentët, ku ata janë në qendër të procesit mësimor. Ky format stimulon zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, duke inkurajuar studentët që të angazhohen aktivisht, të shpërndajnë ide dhe të zhvillojnë aftësi të pavarura për zgjidhjen e problemeve dhe mendimin analitik. Po ashtu, personeli akademik siguron udhëheqjen dhe mbështetjen e vazhdueshme për studentët, duke ndihmuar ata të zhvillojnë autonomi dhe përgjegjësi në mësim. Kjo është e mundur përmes një marrëdhënieje të respektit të ndërsjellë, ku profesorët dhe studentët krijojnë një ambient të hapur dhe të besueshëm për shkëmbimin e ideve dhe reflektimeve. Kjo qasje ndihmon studentët të ndihen të mbështetur dhe të inkurajuar për të arritur potencialin e tyre të plotë. Evidenca nr. 15: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Evidenca nr. 39: Plani i Aktiviteteve për Vitin akademik 2023-2024 Evidenca nr. 60: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2023-2024
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në Shkenca Komunikimi angazhohet në një proces të vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të formave dhe metodave të mësimdhënies. Ky proces realizohet në mënyrë periodike dhe përfshin një përfshirje aktive të studentëve, të cilët japin mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e metodologjisë dhe përvojës mësimore. Përmes anketave të rregullta, grupeve të diskutimit dhe përgjigjeve të drejtpërdrejta nga studentët, njësia mund të reflektojë dhe implementojë këshillat dhe kërkesat e tyre për të optimizuar procesin mësimor.

	Ky angazhim i drejtpërdrejtë me studentët jo vetëm që ndihmon për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, por gjithashtu siguron që programi të mbetet i përshtatshëm dhe relevant për nevojat dhe kërkesat e studentëve. Kjo qasje gjithashtu mundëson që metodat e mësimdhënies të reflektojnë ndryshimet në teknologjitë e reja, kërkesat e tregut të punës dhe stilet e ndryshme të të nxënit, duke siguruar një përvojë mësimore të larmishme dhe të efektshme. <i>Evidenca nr. 57: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik</i> <i>Evidenca nr. 17: Formulari i Vetëvlerësimit për Stafin Akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka krijuar dhe organizuar struktura të dedikuara në nivel institucional, siç është Njësia për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Caktimin e Cilësisë (NJSBC), të cilat promovojnë dhe mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Këto struktura luajnë një rol kyç në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të mësimdhënies mes njësive kryesore/bazë të programit të studimit, duke siguruar që përmirësimi i cilësisë të jetë i vazhdueshëm dhe i strukturuar. Dy herë në çdo vit akademik, në përfundim të semestrit, institucioni zhvillon një anketim vlerësues për stafin akademik, i cili ka për qëllim marrjen e informacionit në lidhje me cilësinë dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik. Anketa plotësohet nga studentet për çdo lëndë dhe pedagog. Njësitë përgjegjëse janë gjithashtu të angazhuara në mbështetje të eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, duke incizuar përdorimin e teknologjive të reja, formave të mësimdhënies interaktive dhe strategjive që inkurajojnë më shumë angazhimin dhe kreativitetin e studentëve. Për më tepër, këto struktura trajnojnë vazhdimisht personelin akademik, duke i ofruar mundësi për përmirësimin e aftësive didaktike dhe implementimin e metodave të reja, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë mësimore dhe ofrimin e një përvoje të pasur për studentët. Ky angazhim për përmirësim të qëndrueshëm dhe inovacion të vazhdueshëm në metodologjinë e mësimdhënies siguron që programi i studimit të jetë gjithmonë në hap me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës, dhe të ofrojë studentëve një mjedis

	mësimor të cilësisë së lartë që është gjithashtu i përshtatshëm për zhvillimet e ardhshme të fushës së komunikimit. Evidenca nr. 28: Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2024 Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr.16 Mjediset e Fakultetit/ Njësive bazë.			
Konkluzione	Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit të Shkencave të Komunikimit, duke krijuar një strukturë të konsoliduar që mbështet koordinimin e aktiviteteve mësimore dhe promovon përdorimin e metodave inovative dhe efikase. Përdorimi i strukturave të dedikuara, si Njësia për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Caktimin e Cilësisë (NJSBC), ka mundësuar një përpjekje të koordinuar dhe sistematike për përmirësimin e përvojës mësimore për studentët dhe mbështetje të vazhdueshme për personelin akademik. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit dhe ekspozimi ndaj metodave të reja të mësimdhënies, si dhe trajnimi i personelit akademik, siguron që programi i studimit është gjithmonë në përputhje me nevojat dhe kërkesat dinamike të tregut të punës, si dhe kërkesat e studentëve për një mësim të pasur, inovativ dhe të angazhuar. Ky proces i vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi i metodologjisë dhe i mësimdhënies ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e përgjithshme të edukatës dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale që i presin në fushën e komunikimit. Një qasje e tillë siguron që studentët të zhvillojnë aftësitë kritike dhe krijuese, të cilat janë të nevojshme për suksesin e tyre në tregun e punës dhe në vijim të studimeve të mëtejshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Informacionin mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive, dhe aftësive të posaçme që merr studenti ofrohet që në momentin që ai aplikon për tu bërë pjesë e programit të studimit. Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe

profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	aftësive profesionale në programin e studimit Shkenca Komunikimi janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Institucionit dhe në dokumentacionin përkatës të programit të studimit. Këto rregullore parashikojnë mënyrën e organizimit të vlerësimit për secilën lëndë dhe modul, duke përcaktuar peshën e komponentëve të vlerësimit si: provimet, detyrat e kursit, projektet, prezantimet, pjesëmarrja aktive në mësim, si dhe puna praktike. <i>Evidenca nr. 20: Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 5: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i> <i>Evidenca nr. 6: Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Parë</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ në takimin me studentët shtroi pyetje në lidhje me informacionin që ata zotëronin mbi lëndët e ndjekura. Studentët na informuan se ata informohen në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, në fillim të çdo lënde apo moduli, për metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore. Ky informacion jepet drejtpërdrejt nga titullari i lëndës/modulit dhe është i pasqyruar në syllabuset përkatëse, të cilat përmbajnë detaje mbi format e vlerësimit (provime, ese, projekte, pjesëmarrje aktive, prezantime etj.), peshën në përqindje të secilit komponent, si edhe afatet kohore për dorëzimin apo realizimin e tyre. <i>Evidenca nr.79: Shembull Sylabusi</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e vlerësimit për këtë program studimi janë forma tradicionale të testimeve. Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve në mënyrë që studentët të jenë të informuar. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të lëndëve studentët vlerësohen: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 0-15% , testime gjatë vitit 30-40 % , detyra/projekt kursi 10-30% , provimi përfundimtar 30-60 %. Procesi i testimit dhe vlerësimit në programin e studimit Shkenca Komunikimi zhvillohet përmes formave dhe metodave të ndryshme, duke u përshtatur me lëndën/modulin specifik, natyrën e kompetencave që synohen të zhvillohen dhe karakteristikat e studentëve. Në këtë kuadër, përdoren teknika të larmishme vlerësimi si: provime me shkrim dhe me gojë, ese analitike, projekte individuale apo në grup, prezantime, raste studimore, si dhe vlerësim të pjesëmarrjes dhe angazhimit aktiv në mësim.

	Këto forma të ndryshme testimi krijojnë hapësira të shumta që studentët të demonstrojnë njohuritë teorike, aftësitë praktike, të menduarit kritik dhe kreativitetin e fituar gjatë studimeve. Një qasje e tillë gjithashtu ndihmon në zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit dhe duke siguruar një vlerësim më gjithëpërfshirës dhe objektiv të arritjeve të secilit student. <i>Evidenca nr. 77: Syllabus-et e lëndëve të programit</i> <i>Evidenca nr. 38: Organizimi i Provimeve Finale të Departamentit</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë dhe personeli akademik i përfshirë në programin e studimit në Shkenca Komunikimi angazhohet në një proces të vazhdueshëm reflektimi dhe përmirësimi të metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit. Mendimet dhe sugjerimet e studentëve konsiderohen si burim me vlerë për përshtatjen e mënyrës së mësimdhënies me nevojat reale të nxënësve dhe përmirësimin e cilësisë së përvojës akademike. Si rezultat, personeli akademik ka mundësinë të rishikojë format e përdorura, të eksperimentojë me metoda më interaktive, si dhe të rregullojë balancën mes teorisë dhe praktikës në varësi të reagimeve të marra. Kjo praktikë ndihmon në ndërtimin e një kulture akademike të hapur dhe bashkëpunuese, ku studentët ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë në përmirësimin e programit, duke ndikuar pozitivisht në motivimin dhe përfshirjen e tyre në procesin mësimor. <i>Evidenca nr. 14: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët</i> <i>Evidenca nr. 12: Anketë Vlerësimi i Studentëve për Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 68: Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në këshillin e departamentit dhe në këshillat e fakulteteve</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit,	Procesi i mësimdhënies në KUB vlerësohet në mënyrë periodike. NJSBC luan një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e personelit akademik duke kontrolluar literaturën që ofrohet në auditore si dhe duke analizuar pyetësorët e studentëve. Një rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit luajnë studentët të cilët vlerësojnë stafin akademik në përfundim të një lëndë të ndjekur dhe marrin pjesë në takimet e zhvilluara në fokus grupe me qëllim vlerësimin e

objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	metodikave të mësimdhënies. Zhvillimi i detyrave të kursit, pjesëmarrja në leksione të hapura, në praktika mësimore dhe jo vetëm, bën që studenti të fitojë autonominë. Pas vizitës në institucion GVJ gjykon se marrëdhënia student-staf akademik është një marrëdhënie e shëndetshme e cila nxit formimin profesional të studentëve të cilët janë pjesë e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”. <i>Evidenca nr. 72: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së</i> <i>Evidenca nr. 73: Vendimi i këshillit të Departamentit për Përcaktimin e përfaqësuesit pranë NJSBC-së</i> <i>Evidenca nr. 14: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët</i> <i>Evidenca nr. 57: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik</i> <i>Evidenca nr. 62: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve</i>			
Konkluzione	<i>Procesi i testimit dhe vlerësimit në programin e studimit Shkenca Komunikimi është i strukturuar, transparent dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike, duke garantuar një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve.</i> <i>Studentët njoftohen në kohë për metodologjinë e vlerësimit përmes syllabuseve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me titullarin e lëndës, duke rritur transparencën dhe pritshmëritë e qarta për performancën akademike.</i> <i>Përdorimi i formave të ndryshme të vlerësimit (provime, ese, projekte, prezantime, etj.) u jep studentëve mundësinë të demonstrojnë në mënyrë të plotë njohuritë e fituara dhe të shprehin potencialin e tyre në mënyra të ndryshme, sipas natyrës së lëndës dhe stilit individual të të nxënit.</i> <i>Për më tepër, përfshirja aktive e studentëve në reflektimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit tregon për një qasje dinamike dhe cilësore të institucionit, e cila synon të rrisë efektivitetin e procesit mësimor dhe të përgatisë studentët për sfidat e tregut të punës dhe të studimeve të mëtejshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në programin e studimit Shkenca Komunikimi, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Titullarët e lëndëve përcaktojnë qartë në fillim të semestrit komponentët e vlerësimit, si: detyrat periodike, prezantimet, pjesëmarrja aktive, projektet ndërdisiplinore, si dhe provimi përfundimtar. Kjo mënyrë e ndarjes së vlerësimit i jep studentëve mundësi të shfaqin progresin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, duke ulur presionin e një vlerësimi të vetëm final dhe duke siguruar një pasqyrim më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të arritjeve të tyre akademike. Vlerësimi i përhershëm nxit studentët të angazhohen në mënyrë të qëndrueshme me përmbajtjen e lëndëve dhe të ndërtojnë aftësi të qëndrueshme praktike dhe teorike. Ky sistem është në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së të nxënës, duke përforcuar një qasje të qëndrueshme dhe të ndërtuar mbi performancën progresive të studentit. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 79: Shembull Syllabusi</i> <i>Evidenca nr. 38: Organizimi i Provimeve Finale të Departamentit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në lidhje me formatin e provimeve, Institucioni zbaton sisteme tradicionale përmes kopjeve fizike të cilat zhvillohen në auditor por edhe nëpërmjet formave të tjera të vlerësimit si projekte të cilat mund t'i dorëzojë në kopje elektronike dhe fizike. Notat për të gjitha mënyrat e vlerësimit hidhen në Sistemin Informativ Bedër (BIS), të aksesueshme në kohë reale.
	Zbatimi i kësaj teknologjie ndihmon në rritjen e transparencës, pasi studentët kanë akses të drejtpërdrejtë në notat e tyre, kriteret e vlerësimit dhe komentet e mësuesve në mënyrë të dokumentuar. Për më tepër, sistemet elektronike minimizojnë mundësinë e abuzimeve apo subjektivitetit në



	vlerësim, duke siguruar një proces të drejtë, të njëjtë për të gjithë studentët dhe të mbështetur në evidenca të qarta. Evidenca nr. 83: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndëve në programin e studimit Shkenca Komunikimi realizohet në përputhje të plotë me syllabusin përkatës dhe me bazën ligjore në fuqi, siç parashikohet në Rregulloren e Institucionit dhe në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit. Titullari i lëndës ndjek metodologjinë e vlerësimit të miratuar dhe të bërë publike që në fillim të semestrit, duke respektuar peshën specifike të çdo komponenti vlerësues (provim, projekt, detyra kursi, pjesëmarrje etj.). Kjo praktikë garanton transparencë, objektivitet dhe barazi për të gjithë studentët, duke shmangur ndryshime të paarsyeshme apo të paautorizuara në mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu, vlerësimi përfundimtar pasqyron performancën reale të studentit gjatë gjithë semestrit, duke qenë i bazuar në kriteret e paracaktuara dhe të njohura më parë. Evidenca nr.79: Shembull Sylabusi Evidenca nr. 10: VKM nr.41 më datë 24.01.2018
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në programin e studimit Shkenca Komunikimi, procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale shoqërohet, kur është e nevojshme, me komente dhe feedback konstruktiv nga ana e stafit akademik. Këto komente ndihmojnë studentët të kuptojnë pikat e tyre të forta, por edhe aspektet që duhet të përmirësojnë, duke e parë vlerësimin jo thjesht si një notë përfundimtare, por si një mjet për të nxitur reflektimin dhe zhvillimin personal e profesional. Feedback-u ofrohet në mënyrë të personalizuar, sidomos në detyrat me natyrë analitike ose krijuese si ese, projekte, prezantime apo punime praktike, duke i udhëzuar studentët drejt një përmirësimi të vazhdueshëm. Për më tepër, kjo qasje ndihmon në zhvillimin e aftësive të të nxënës të pavarur, rrit vetëdijen akademike dhe përgatitjen për situata reale të tregut të punës. Ky proces është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kontribuon ndjeshëm në rritjen e cilësisë së të nxënës dhe motivimit të studentëve për progres të vazhdueshëm.

	Evidenca nr. 38: Organizimi i Provimeve Finale të Departamentit
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik zbatojnë masa të qarta për të shmangur dhe parandaluar plagjiaturën, kopjimin dhe çdo formë tjetër të pasinqeritetit akademik, në përputhje me Rregulloren e Institucionit dhe politikat e integritetit akademik. Studentët informohen që në fillim të studimeve mbi pasojat e sjelljeve të tilla, si dhe mbi rregullat e citimit dhe referimit të burimeve, duke u edukuar për të ndërtuar punë origjinale dhe të bazuar në etikë akademike. Dorëzimi i detyrave realizohet përmes platformave elektronike, të cilat shpesh janë të integruara me sisteme të detektimit të plagjiaturës (Bedër Plagiarism Checker System). Gjithashtu, gjatë provimeve dhe vlerësimeve, merren masa organizative dhe teknike për të siguruar monitorim efektiv dhe kushte të barabarta, duke ruajtur integritetin e procesit. Kjo qasje përforcon kulturën e ndershmërisë dhe meritokracisë, e cila është themelore për cilësinë e arsimit të lartë dhe për përgatitjen profesionale të studentëve në mënyrë të përgjegjshme dhe të besueshme. https://pds.beder.edu.al Evidenca nr. 64: Rregullorja e disiplinës së studentëve Evidenca nr. 20: Guida e Studentit Evidenca nr. 38: Organizimi i Provimeve Finale të Departamentit
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në programin e studimit Shkenca Komunikimi, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen gjithmonë në meritë e studentëve dhe janë të drejta dhe objektive, duke respektuar standardët e përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit. Vlerësimi është i bazuar në performancën reale të studentëve gjatë procesit të të nxënit, përfshirë pjesëmarrjen, detyrat e kursit, provimet dhe punimet finale. Sistemi i vlerësimit është krijuar për të inkurajuar kualifikimin dhe zhvillimin e aftësive të studentëve, duke kontribuar në mjedisin akademik të ndershëm dhe të barabartë, dhe duke forcuar besimin e studentëve në procesin e vlerësimit dhe në integritetin e tij. Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"



Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në programin e studimit Shkenca Komunikimi, institucioni garanton të drejtat e studentëve për të qenë të informuar dhe të kenë mundësi të shprehin mendimet e tyre mbi procesin e vlerësimit. Studentët kanë të drejtën e njohjes me rezultatet e vlerësimit dhe janë të informuar për kritere të vlerësimit dhe metodat e përdorura nga personeli akademik që në fillim të çdo semestri, përmes syllabuseve dhe njoftimeve të qarta.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast se studentët mendojnë se vlerësimi i tyre është jo i drejtë apo ka ndodhur një gabim, ata mund të kërkojnë rishikimin e vlerësimit, brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, sipas procedurave të parashikuara në statutin e institucionit, rregulloret dhe manualët e përkatshme. Ky proces i rishikimit është i strukturuar dhe siguron që çdo kërkesë të trajtohet në përputhje me standarde të larta të transparencës dhe drejtësisë, duke garantuar se çdo vendim është i arsyetuar dhe i bazuar në meritë. Ankimimi që lidhet me procesin e vlerësimit shqyrtohet nga një komision i vlerësimit, i përberë nga tre veta i cili ka për detyrë të sigurojë një analizë të drejtë dhe objektive të kërkesës. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Të gjitha procedurat dhe vendimet që lidhen me ankimimet dhe kërkesat janë të dokumentuara dhe arkivuar, duke siguruar që gjithçka të jetë në përputhje me rregulloret dhe politikat akademike të institucioneve përkatëse. <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i> <i>Evidenca nr. 48: Procedura e Ankimimit të Notës</i>
Konkluzione	<i>Në përputhje me kriteret dhe procedurat e përmendura, programi i studimit Bachelor në " Shkenca Komunikimi" siguron një proces vlerësimi transparent dhe të drejtë, që i garanton studentëve të drejtat e tyre për t'u njohur me rezultatet e vlerësimit, si dhe mundësinë e ankimeve dhe rishikimit të vlerësimeve në rast të paqartësive ose gabimeve.</i>

	<i>Institucioni ka krijuar mekanizma të qartë për të siguruar që çdo kërkesë dhe ankimim shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe objektive nga komisionet përkatëse, duke garantuar një proces të strukturuar dhe të dokumentuar, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët.</i> <i>Ky proces është i mbështetur në standardet ligjore dhe akademike të institucionit, duke ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e vlerësimit dhe duke mundësuar që çdo vendim të merret në përputhje me meritën dhe në mbështetje të zhvillimit të aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve.</i> <i>Përfundimisht, transparencë, drejtësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve të vlerësimit janë të integruara në kulturën akademike të institucionit, duke mundësuar një përvojë edukative të besueshme dhe të drejtë për të gjithë studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Shkenca Komunikimi është projektuar me qëllimin kryesor të thellimit të njohurive dhe zhvillimit të aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. Ky program synon që studentët të fitojnë një kuptim të thellë të teorive dhe praktikave që lidhen me komunikimin, si dhe t'i përgatisë ata për të përballuar sfidat e fushës profesionale. Përmes lëndëve të specializuara dhe modulëve të strukturuar sipas nevojave të tregut të punës, studenti ka mundësinë të zhvillojë aftësi të avancuara analitike dhe praktike, duke përfshirë edhe aftësinë për të komunikuar efektivisht në mjedise profesionale dhe për të adoptuar teknika dhe strategji inovative në fushat e komunikimit dhe medias. Ky program jo vetëm që thellon njohuritë e studentëve në aspektet teorike të komunikimit, por gjithashtu i përgatit ata për zbatimin praktik të këtyre njohurive, duke i siguruar atyre një bazë solide për karrierë profesionale në një gamë të gjerë

	sektorësh, si media, marketing, PR, dhe fushat e tjera të komunikimit. Përmes një strukture mësimore të balancuar dhe të orientuar drejt rezultateve të nxënësve, ky program garanton zhvillimin e aftësive profesionale që janë të nevojshme për të përballuar kërkesat e tregut të punës dhe për të siguruar një sukses afatgjatë në fushën e komunikimit. <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr. 9-10</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Shkenca Komunikimi ofron një bazë të fortë për zhvillimin e aftësive të veçanta që lidhen me disa fusha kyçe si teknologjia e informacionit, shkencat humane, shkencat sociale, dhe natyrisht komunikimi dhe ndërveprimi. Kjo ndihmon në formimin e profesionistëve që janë të aftë të kuptojnë dhe të përdorin mjetet dhe teknologjitë më të fundit për të komunikuar dhe bashkëvepruar me audiencat e ndryshme. Përmes moduleve që mbulojnë aspekte të komunikimit digjital, teknologjisë së informacionit dhe media sociale, studentët fitojnë aftësinë për të përdorur platforma dhe mjete teknologjike që janë thelbësore për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes, si dhe për menaxhimin e informacionit në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar. <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Komunikimi" është i strukturuar në mënyrë që të sigurojë një lidhje të ngushtë midis kompetencave dhe aftësive që studenti zhvillon dhe analizës së vazhdueshme të përparimit të tij gjatë programit. Çdo lëndë dhe modul përmban syllabusin përkatës, i cili përcakton qartë kompetencat e synuara dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Në përfundim të secilës lëndë, personeli akademik realizon një proces reflektimi dhe vlerësimi për të shqyrtuar se si janë arritur këto kompetenca dhe aftësi. Ky proces është i rëndësishëm për orientimin e studentëve mbi çështjet më të rëndësishme të përvetësuar gjatë lëndës, si dhe për të udhëzuar ata për detyrimet përmbyllëse të lëndës, siç mund të jenë detyrat, projektet ose provimet.

	Në këtë mënyrë, personeli akademik angazhohet jo vetëm në zhvillimin e aftësive profesionale dhe teorike të studentëve, por gjithashtu orienton dhe mbështet studentët për të siguruar që ata të mund të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në praktika reale dhe në karrierën e tyre të ardhshme. Ky proces reflektimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm mundëson një përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënies, duke siguruar që programi të mbetet i përditësuar dhe i përshtatur me kërkesat e tregut të punës. <i>Evidenca nr. 10: VKM nr.41 më datë 24.01.2018</i> <i>Evidenca nr. 14: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Syllabuset e programit të studimit në lëndët karakterizuese janë të hartuara në formë të tillë që u japin mundësinë studentëve të kenë një formim teorik që ofron shembuj nga tregu real i punës. Këto njohuri studenti ka mundësi ti vërë në jetë gjatë periudhës së praktikës profesionale. Institucioni u ofron mundësinë studentëve të zhvillojnë praktikën në institucione të ndryshme. Për më tepër, është e rëndësishme që format e mësimdhënies të ndërthuren me institucionet bashkëpunuese dhe me mundësi që mundësojnë mobilitetin e studentëve, duke iu ofruar mundësi për të përfituar eksperiencë dhe njohuri të reja si në kontekstin vendas, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ky bashkëpunim është i dobishëm për studentët, pasi mundëson ndërtimin e lidhjeve profesionale, si dhe rrit mundësitë e tyre për një punësim më të lehtë pas përfundimit të studimeve. <i>Evidenca Shtojca, Tabela përmbledhëse-Tabela nr. 17-18</i> <i>Evidenca nr. 78: Sylabusi i Lëndës Praktikë Profesionale</i> <i>Evidenca nr.79: Shembull Sylabusi</i> <i>Evidenca nr. 25: Kurrikula e programit "Bachelor në Shkenca Komunikimi"</i> <i>Evidenca nr. 16: Dokument pjesëmarrje të studentëve në programe shkëmbimi</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	Ky kriter thekson rëndësinë e angazhimit të personelit akademik në zhvillimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive të studentëve përmes orëve të hapura dhe seminareve. Ato janë mundësi që personeli akademik ofron për t'i mbajtur studentët të informuar për zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë të

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	përditësuar me trendet dhe kërkesat e fushës së komunikimit dhe përfshirjen e teknologjisë. Në veçanti, leksionet e hapura, seminarët dhe workshop-et mund të shërbejnë si një platformë për diskutime dhe shkëmbime ideje, ku studentët mund të ndajnë mendimet dhe pyetjet e tyre mbi temat më të fundit të studimit. Ky angazhim gjithashtu përforcon lidhjen midis teorisë dhe praktikës, duke mundësuar që studentët të aplikojnë njohuritë teorike në kontekste reale dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale. Për më tepër, zhvillimi i seminarëve që mbulojnë trendet më të reja në shkencën dhe teknologjinë, veçanërisht në fushën e komunikimit (p.sh. komunikimi digjital, media sociale, teknologjitë e reja për transmetimin e informacionit), i ndihmon studentët të ndjekin avancimet në këtë fushë, duke u mundësuar atyre që të bëhen më të përgatitur për tregun e punës dhe për sfidat e reja profesionale. <i>Evidenca nr. 39: Plani i Aktiviteteve për Vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 59: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2022-2023</i>
Konkluzione	Në përputhje me kërkesat dhe standardet e vendosura, programi i studimit në fushën e komunikimit ka implementuar masa dhe struktura të duhura për të siguruar një përvojë të pasur mësimore për studentët, duke i mundësuar atyre zhvillimin e aftësive profesionale dhe teknike të nevojshme për të qenë të suksesshëm në tregun e punës. 1. Angazhimi i personelit akademik është i rëndësishëm për sigurimin e një mësimdhënieje efektive dhe të përditësuar që reflekton zhvillimet më të fundit në fushat e shkencës dhe teknologjisë. Leksionet e hapura workshop-et dhe seminarët për zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë kontribuojnë në pasurimin e njohurive të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e ardhshme profesionale. 2. Përditësimi i vazhdueshëm i metodave dhe materialeve mësimore siguron që programi i studimit të qëndrojë relevant dhe të përshtatet me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë zhvillime të reja teknologjike dhe kërkesat e industrisë. 3. Lidhja e ngushtë midis teorisë dhe praktikës është një faktor kyç që ndihmon studentët të kuptojnë konceptet

	teorike dhe t'i zbatojnë ato në situata reale. Ky proces u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësi kritike dhe krijuese, të cilat janë thelbësore për suksesin e tyre në karrierë. 4. Konsultimet dhe përfshirja e studentëve në proceset e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe feedback-u i rregullt, sigurojnë që çdo individ të ndihmohet për të përmirësuar performancën e tij dhe të përgatitet për sfidat e ardhshme profesionale. Në përgjithësi, programi i studimit është i dizajnuar për të garantuar që studentët të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për t'u angazhuar në fusha të ndryshme profesionale, duke i mundësuar atyre të adaptohen dhe të kenë sukses në një mjedis gjithnjë e më të teknologjizuar dhe të ndryshueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në përputhje me kriteret e përcaktuara për procedurat e vlerësimit dhe përfundimin e studimeve, institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Kjo rregullore është e qartë dhe e detajuar për studentët, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent në lidhje me përfundimin e programit të studimit. Përmes përcaktimit të pragut të notës mesatare, institucioni vendos një kriter të rëndësishëm për ata studentë që janë të gatshëm të përfundojnë studimet e tyre me një punim diplome. Ky prag i notës mesatare, i bërë publik për studentët, siguron që ata të kenë arritur një nivel të caktuar akademik për të kaluar në fazën e fundit të studimeve dhe për të realizuar punimin e diplomës. Ky kriter është gjithashtu një garanci që procesi i testimit dhe vlerësimit është i strukturuar dhe i mbështetur në parime të

	drejta, duke siguruar që studentët të mund të përfundojnë studimet në përputhje me kërkesat dhe standardet akademike. <i>Evidenca nr. 30: Manuali për përgatitjen së diplomës për studentët e ciklit të parë</i> <i>Evidenca nr. 6: Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Parë</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Në përputhje me kërkesën e këtij kriteri, struktura përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë periudhës së përgatitjes për detyrimet përmbyllëse, si provimet përfundimtare ose punimi i diplomës. Kjo mbështetje siguron që studentët të kenë akses në informacionet dhe burimet e nevojshme për t'u përgatitur në mënyrë efikase dhe të suksesshme. Përmes ofrimit të udhëzimeve të qarta dhe materialeve të nevojshme, si dhe mbështetjes praktike dhe akademike, institucionet e mundësojnë që studentët të kenë të gjitha mjetet për të përmbushur detyrimet përmbyllëse. Kjo gjithashtu mundëson një kalim më të lehtë dhe të strukturuar nga periudha e mësimdhënies në atë të testimit dhe përfundimit të studimeve. Ky proces ofron transparencë dhe besueshmëri për studentët, duke u mundësuar atyre të arrijnë objektivat e përcaktuara në programin e studimit dhe të përfundojnë me sukses detyrimet përmbyllëse. <i>Evidenca nr. 30: Manuali për përgatitjen së diplomës për studentët e ciklit të parë</i> <i>Evidenca nr. 19: Sylabusi i Lëndës "Punimi i Diplomës"</i> <i>Evidenca nr. 21: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky kriter thekson rëndësinë e një vlerësimi të drejtë dhe gjithëpërfshirës për provimin final. Administrimi i provimit duhet të reflektojë njohuritë dhe aftësitë që studenti ka zhvilluar gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke marrë parasysh përmbajtjen dhe rëndësinë e çdo lënde dhe moduli. Komisioni i posaçëm që administron provimin final ka përgjegjësinë për të siguruar që ky vlerësim të mbulojë të gjitha aspektet e programit të studimit, duke i dhënë peshën e duhur çdo moduli në përputhje me rëndësinë që ka për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve.

	Kjo qasje është një mundësi për të siguruar që studentët vlerësohen për një spektër të gjerë njohurish dhe aftësish, që janë të nevojshme për të përfunduar me sukses programin e studimit. Gjithashtu, është e rëndësishme që testimi të jetë objektiv dhe i balancuar, duke mundësuar që çdo student të demonstrojë njohuritë dhe aftësitë që ka fituar gjatë gjithë studimeve. Në këtë mënyrë, ky kriter siguron që vlerësimi i studentëve të jetë gjithëpërfshirës dhe i drejtë, duke i dhënë mundësinë secilit student të dëshmojë përgatitjen e tij/sa të plotë për profesionin që do të ndiqet pas diplomimit. <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikim"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Ky kriter thekson rëndësinë e udhëheqësit të diplomës në procesin e orientimit dhe mbështetjes së studentëve për realizimin e punimit të diplomës. Udhëheqësi i diplomës luan një rol kyç në udhëzimin e studentëve gjatë gjithë procesit, duke ndihmuar ata të zgjedhin tema të përshtatshme, të kryejnë kërkime të thella dhe të organizojnë informacionin në një punim koherent dhe shkencor. Kjo mbështetje është e rëndësishme për të siguruar që studenti të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të prodhuar një punim të kualifikuar, që reflekton njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është garantimi i cilësisë së punimit të diplomës. Udhëheqësi ka përgjegjësinë për të siguruar që punimi i diplomës të plotësojë kërkesat shkencore dhe akademike, dhe të jetë i përgatitur sipas standardeve të miratuara nga institucioni. Kjo është një garanci që punimi do të përmbushë kritere të larta akademike dhe do të jetë një pasqyrim i përpjekjeve dhe njohurive të studentit. <i>Evidenca nr. 19: Sylabusi i Lëndës "Punimi i Diplomës"</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ky kriter është shumë i rëndësishëm, pasi ai siguron mbështetje praktike dhe teknike për studentët në realizimin e kërkimeve dhe testeve të nevojshme për punimet e diplomës ose projektet akademike. Njësia bazë, që mund të përfshijë laboratorë, ekipe kërkimore ose struktura të tjera mbështetëse brenda institucionit, ka një rol kyç në ndihmën ndaj studentëve për t'u siguruar që ata të kenë akses në mjetet dhe resurset e nevojshme për realizimin e kërkimeve të tyre. Udhëheqësi i diplomës është përgjegjësi kryesor i cili ndërmjetëson studentet në nevojat e

	tyre kundrejt institucionit në lidhje me realizimin me sukses të përgatitjes së diplomës. <i>Evidenca nr. 30: Manuali për përgatitjen së diplomës për studentët e ciklit të parë</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Ky kriter është esencial për përfundimin e procesit të studimeve dhe përcaktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive të studentit. Vlerësimi i studentëve me një notë pas provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës është një praktikë e zakonshme dhe e nevojshme në çdo program studimi, pasi ndihmon në: përcaktimin e arritjeve akademike, sigurimin i transparencës dhe drejtësisë, përgatitjen për hapat e ardhshëm, përmirësimin e cilësisë. Në përfundim, ky kriter është një hap i rëndësishëm për të siguruar që procesi i testimit dhe vlerësimit i studentëve të jetë i qartë, i strukturuar dhe i ndihmon studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike dhe profesionale. <i>Evidenca nr. 76: Vendim për ngritjen e jurive të diplomave Bachelor</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pajisja e studentit me diplomën dhe suplementin e diplomës është një proces i rëndësishëm, sepse ato janë dokumentet që vërtetojnë përfundimin e studimeve dhe arritjet akademike të studentit. Suplementi i diplomës është një dokument shtesë që shpjegon përmbajtjen e programit të studimit, lëndët e ndjekura, kreditet e fituara dhe vlerësimin përfundimtar të studentit. Ky suplement është një mjet i rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe njohjen ndërkombëtare të arritjeve akademike dhe lëshohet sipas formateve të licencuara dhe të aprovuara nga MASR. <i>Evidenca nr. 6: Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Parë</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dhe arkivon dokumentacionin e studentëve duke ofruar mundësinë për të marrë informacion në lidhje me atë kur është e nevojshme. Kjo është një praktikë e rëndësishme për transparencën, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve. Ky kriter është i domosdoshëm për të siguruar menaxhimin e duhur dhe të sigurt të të dhënave personale dhe akademike të studentëve. Ai garanton që informacioni mbi studentët të ruhet dhe mund të ofrohet në përputhje me kërkesat ligjore, duke respektuar të drejtat e studentëve për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave. Ky proces është esencial për ruajtjen e cilësisë




	dhe besueshmërisë së institucioneve edukative dhe mbështet studentët në aksesin e informacionit të nevojshëm për qëllime të ndryshme, si dhe për sigurinë e të dhënave të tyre personale.			
	<i>Evidenca nr. 63: Rregullorja e Arkivës</i>			
Konkluzione	Në konkluzion mund të thuhet se Institucioni, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e mira të menaxhimit të të dhënave, respekton rëndësinë e ruajtjes dhe ofrimit të informacionit për studentët. Institucioni siguron që dokumentacioni i studentëve të ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që ky informacion të jetë i disponueshëm kur kërkohet nga autoritetet përkatëse. Në këtë kuadër, ruajtja e të dhënave duhet të jetë e sigurt, transparente dhe e menaxhuar siç duhet, për të garantuar që të drejtat e studentëve për privatësi dhe mbrojtje të informacionit të jenë të plota. Kjo është themelore për sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për studentët, dhe për të mbështetur cilësinë dhe integritetin e institucioneve akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV.IBURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e	Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga KU BEDER Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në programin e studimit Bachelor “Shkenca Komunikimi” përmbushin kriteret ligjore për nivelin e kualifikimit për mbulimin e lëndëve dhe moduleve dhe eksperiencës në përputhje me këtë program studimi. Njësia bazë e programit të studimit, që është Departamenti i Shkencave të Komunikimit përcakton fushën e kompetencës dhe

kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

nivelit akademik të stafit si atyre PAE dhe PAK (në bashkëpunim me Rektoratin). Niveli i kualifikimit për stafin akademik që jep mësim në programin e studimit Bachelor “Shkenca Komunikimi” është si me poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	1	1	1	-	-	-
Dr	7	1	5	1	3	-
MSc	11	3	6	3	4	2
Total	19	5	12	4	7	2

Evidenca 5. Rregullorja e Fakultetit të shkencave Humane dhe Drejtësisë

Evidenca 6. Rregullorja e programit të studimit të Ciklit të parë

Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit të “Bachelor në Shkenca komunikimi”

Evidenca 15. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse. Tabela 7

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Mbështetur në dokumentacioni e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se KU “BEDËR” kujdeset që personeli akademik efektiv të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ngarkesa e pedagogeve është brenda normave të caktuara. Nga shikimi i tabelës ku paraqitet ngarkesa akademike e stafit për vitin akademik 2024-2025, lidhur me programin e studimit Ciklit të Parë Bachelor “Shkenca Komunikimi” rezulton se rreth 84% ngarkesës mësimore orë në auditor mbulohet nga staf akademik efektiv/ i brendshëm PAE dhe 16% nga personeli me kontratë, PAK. Ky tregues ka qenë 17% për vitin 2023-2024 dhe 10% në vitin 2022-2023.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, gjatë vitit aktual mësimor 2024-2025 ka 11 pedagogë efektivë, PAE.

Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 12.1

Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 1

Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 6.3

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe

Nga analizimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të përcjellë nga KU “Bedër”, Grupi i Vlerësimit

të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik ka treguar qëndrueshmëri, dhe kjo si përsa i përket programit të studimit, ashtu edhe Departamentit. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me dosjen e plotë stafit të departamentit e cila përmban edhe kontratat e punës dhe mbulimin me sigurimet shoqërore. <i>Evidenca 15. CV e stafit akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	KU “Bedër” ka hartuar proceduara të përcaktuara lidhur me menaxhimin e Burimeve Njerëzore, rekrutimin dhe vlerësimin e tij. Sipas “Procedurës së rekrutimit të stafit akademik” institucioni ka ngritur të ndërtuara hapat bazë për rekrutimin ashtu edhe procedurën që duhet ndjekur për lëvizjet e brendshme të stafit. Përzgjedhja e stafit fillon që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/intervistimit. Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevojës që ka programi i studimit. <i>Evidenca nr. 50. Procedura e rekrutimit të stafit akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se KU “Bedër” ka burime njerëzore edhe personel ndihmës akademik që është i mjaftueshëm për të realizuar programin mësimor të Bachelor në “Shkenca Komunikimi”. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ pati kontakt me personalin ndihmës që asiston në këtë program studimi, si vizitoi laboratorët e Teknologjisë së Informacionit, sekretarinë mësimore, muzeun e shkencave të komunikimit dhe pa mjediset e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 1</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se KU “Bedër”, Zyra e Burimeve Njerëzore, ka mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të



personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	pjesëshme) dhe administrativ të angazhuar me programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Komunikimi” duke i përmbledhur të gjitha informacionet në dosje individuale për stafin. Ngarkesa mësimore e stafit akademik, propozohet nga departamenti dhe me pas miratohet nga dekani dhe rektori i universitetit, duke u bazuar në udhëzimet përkatëse. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u morën me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit, si për staf Akademik PAE dhe PAK. GVJ konstaton se dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi arsimin, në të gjitha nivelet; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dosja përmban edhe vlerësimin që i është bërë pedagogut nga studentët; (v) Kontratat e punës në vite, etj. <i>Evidenca nr 21. Vendimi i Keshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore.</i> <i>Evidenca nr 82. Udhëzim për Ngarkesën Mësimore.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni ka një listë të plotë të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis KU “Bedër” dhe institucioneve arsimore dhe jo arsimore që u krijojnë mundësi studentëve në realizimin e praktikave mësimore, si edhe në rritjen e mundësive për studentët. Për periudhën 2024-2026 KU “Bedër” ka marrëveshje në kuadër të programit Erasmus+ me disa universitete të huaja: - “University of Applied Science Lavoslav Ruzicka” në Vukovar, Kroaci; - West University of Timisoara, Rumani; - Universidad de Pontificio de Salamanca. Gjithashtu universiteti është pjesë e networkut CEEPUS “Media in transition” <i>Evidenca nr. 9. Vendimi i Keshillit të Departamentit për Përcaktimin e Përfaqësuesit pranë Zyres së Planifikimit të Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 27. Lista e praktikave profesionale të studenteve</i> <i>Evidenca nr. 26 Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme.pdf</i> <i>Evidenca nr. 35 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktore të biznesit vendas dhe të huaj.pdf</i>

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin prites që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, listat e bashkëpunimit me institucionet pritëse për realizimin e praktikave mësimore, këto institucione organizojnë mikpritjen e studentëve për realizimin e detyrave të tyre.			
	<i>Evidenca nr. 9. Vendimi i Keshillit të Departamentit për Percaktimin e Perfagesuesit pranë Zyres së Planifikimit të Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 49. Procedura e Praktikës Profesionale</i>			
Konkluzione	GVJ, mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit të studimit. Institucioni ka procedura të rregullta rekrutimi, mbledh dhe ruan dokumentacionin mbi personelin akademik të përfshirë në programet e studimit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, institucioni ka mjedise të dedikuara këtij programi studimi dhe që janë në ndihmë të një procesi praktik të të mësuarit për studentët. Të tilla janë: newsroom, muzeu i medias dhe komunikimit, laborator i gjuhëve të huaja dhe kompjuterave, etj. Në evidencën e paraqitur në dokumentet e akreditimit, si shtojcë e raportit të vlerësimit të brendshëm, në tabelën 16, raportohet për një sipërfaqe totale prej 2732.5m ² dhe bazuar në përllogaritjet janë rreth 4.53 m ² / student. Nga vizita e GVJ në mjediset e reja të institucionit u vu re se klasat mjediset mësimore ishin të mjaftueshme, të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për zhvillimin e një orë interaktive mësimore. Ambientet ishin me hapësira të

	mjaftueshme, dhe komode për studentët. Të gjitha ambientet mësimore përshtateshin me numrin e studentëve që frekuentojnë programin. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 16</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita e GVJ në mjediset e institucionit u vu re se mjediset mësimore ishin të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për zhvillimin e një ore mësimi interaktive. Në klasa kishte kompjutera, tabelë projektimi, tabela interaktive dhe internet. Këto mjedise, janë të gjitha të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm. KU “Bedër” ka një newsroom të veçantë që i shërben studentëve të këtij programi por mund të përdoret edhe nga departamentet e tjera. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 16</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e GVJ-së në mjediset e reja të institucionit dhe nga materialet e përcjella nga KU “Bedër”, atje ka mjediset mësimore, për studentët e këtij programi studimi dhe gjithë departamentit. Janë 128 kompjutera, Newsroom, si dhe një muze të medias dhe komunikimit, në të cilin studentët njihen më nga afër me pajisjet teknologjike të përdorura për komunikimin masiv, si dhe atyre më të reja. Të tilla mjediset u mundësojnë studentëve aftësimin praktik, përpos njohurive teorike që marrin nga programi në kuadër të përmbushjes së objektivave formues të programit të studimit në tërësi. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 16</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Studentët që ndjekin programin Bachelor në “Shkenca Komunikimi” kanë në dispozicion dy laboratorë të kompjuterave në të cilin kanë qasje sipas nevojës, si edhe newsroom. Kompjuterat e këtij laboratorit ishin të pajisur më të gjithë programet e nevojshme që iu duhen studentëve të programit për të kryer detyrat e tyre praktike. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 16</i>
Konkluzione	<i>GVJ thekson se KU “Bedër” vë në dispozicion mjediset mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme me salla, laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe mjediset të</i>

	<i>tjera mësimore për realizimin e procesit mësimdhënës në këtë program studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ vëren se institucioni garanton akses për studentët në bibliotekën mësimore dhe garanton shfrytëzim të barabartë të mundësive të saj, për studentët e programit. Nga vizita e grupit të vlerësimit në bibliotekën mësimore u pa se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për këtë qëllim. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe një fond librash fizik të konsiderueshëm. Gjithashtu biblioteka ka rregulla të qarta, orare të mirëpërcaktuara dhe ishte e pajisur me kompjutera, ku studentët mund të bëjnë edhe kërkime online apo në fondin elektronik të institucionit. KU “Bedër” ka edhe marrëveshje me platformën JSTOR për një shfrytëzim më të gjerë të literaturës në ndihmë të programeve të studimit. Aksesit në këtë platformë është falas për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidenca nr 33 Marrëveshja për akses në JSTOR.pdf</i> <i>Evidenca nr 80 Udhezim mbi Funksionimin e Bibliotekës.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia kryesore e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Shkenca Komunikimi” në KU “Bedër” si edhe njësitet e tjera kryesore nxiten të përditësojnë literaturën e programeve të tyre. Marrëdhëniet janë të dyanshme, njësitet kryesore bëjnë kërkesa për shtimin e literaturës ashtu si edhe biblioteka raporton për hyrjet e reja që i shtohen asaj. Biblioteka përmban një fond prej 22.600 titujsh prej të cilëve rreth 560 tituj i përkisnin librave të lidhur me programin që po vlerësohet, Shkenca Komunikimi. Nëpërmjet donacioneve, Ambasada Amerikane në Tiranë kanë ndihmuar në pasurimin e fondit të saj edhe më tepër.

	Në mbledhjet e departamentit bëhen kërkesat për përditësimin e syllabuseve të cilat janë të lidhura edhe me literaturën përkatëse. Literatura për Departamentin e Shkencave të Komunikimit ishte plotësuar edhe nëpërmjet donacioneve nga Instituti Shqiptar i medias dhe një donacion i Ambasadës Amerikane. <i>Evidenca nr. 33 Marrëveshja për akses në JSTOR -----</i> <i>Evidenca nr. 36 Mbledhje e Keshillit të Departamentit për Diskutimin e Syllabuseve</i> <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	KU “Bedër” ka një bibliotekë të pasur me tituj fizikë dhe me akses në platformat online të kërkimit të materialeve. Në bibliotekë janë 24 poste leximi dhe disa kompjutera në funksion të saj. <i>Evidenca nr. 33 Marrëveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka përmban një fond prej 22.600 titujsh, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore. Abonimi në platformën JSTOR krijon akses të mbi 12 milionë artikuj të revistave shkencore. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka edhe abonime specifike që lidhen tek revistat “Business Magazine” dhe gjithashtu zotëron median online “Objektiv” <i>Evidenca nr. 33 Marrëveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Të gjithë studentët dhe anëtarët e stafit të KU Bedër kanë akses pa pagesë në platformën JSTORE. Aksesit realizohet nëpërmjet email personal në KU Bedër dhe aty mund të kërkohen lexohen dhe shkarkohen artikujt e ndryshëm. Biblioteka e KU Bedër mundëson aksesin edhe në Book Academic Collection.

	<i>Evidenca nr. 33 Marrëveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e KU “Bedër” ka kompjutera që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. <i>Evidenca nr. 33 Marrëveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e funksionimit të bibliotekës janë 8:30-19:00. Sikurse përshkruhet në RVB, në periudhën e provimeve biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë. Oraret e funksionimit të bibliotekës janë të publikuara dukshëm për studentët.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Mënyrat për pasurimin e bibliotekës në KU “Bedër” janë të ndryshme. Fondet për blerjen e librave dhe pasurimin e bibliotekës janë të parashikuara në buxhetin e departamenteve. Në konsultim me lektorët e e lëndëve specifike, departamentet dërgojnë kërkesat për literaturën e nevojshme. Në KU “Bedër” biblioteka është pasuruar nga dhurimet e 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadër të projektit të Edukimit Mediatik të Universiteteve. Ndërsa vetë studentët e KU “Bedër” kanë realizuar një projekt për mbledhjen e librave si pjesë e një lënde “Konceptim dhe Menaxhim Fushate”. <i>Evidenca nr. 80 Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17- Të dhëna të plota për platformat on-line/ IT / Biblioteka</i>

Konkluzione	GVJ duke parë dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, dhe pas vizitës vëren se KU "Bedër" ka një bazë fizike të librave që mbështesin literaturën e nevojshme për lëndët e zhvilluar na programin mësimor. Kjo literaturë dhe baza fizike e librave përditësohet në mbështetje të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni ofron falas për stafin dhe studentët platformën online JSTOR për të shfletuar dhe download libra dhe artikuj shkencorë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se institucioni përdor sistemin/programin BIS (Bedër Information System). Ky sistem bën të mundur ruajtjen e të gjithë të dhënave të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të tyre të studimit në institucion. Gjithashtu, studentët dhe stafi akademik që mori pjesë në takimin më grupin e vlerësimit të jashtëm, ishin të njohur mirë me sistemin dhe mund të artikulonin qartë mënyrën e operimit të tij. Sistemi i operimit BIS është i mirë-shpjeguar edhe në Udhëzuesin për përdorimin e këtij sistemi, i paraqitur si evidence nr. 83, në dokumentacionin e vlerësimit të programit. <i>Evidenca nr. 83 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sipas shpjegimeve të dhëna në RVB dhe evidencat e dorëzuara në dosjen e vlerësimit, sistemi i menaxhimit të Brendshëm BIS, ka llogari të hapura për secilën nga grupet, në institucion: studentët, pedagogët, këshilltarët akademike, dhe departamentet e tjera mbështetëse në institucion si p.sh. burimet njerëzore, biblioteka, etj. Në sistemin e menaxhimit të brendshëm institucioni ruan të gjitha të dhënat që lidhen me progresin e studentëve në ciklin e programit. <i>Evidenca nr. 83 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas RVB dhe udhëzuesit për Sistemin Informativ të brendshëm, qasja është e tillë që i gjithë personeli ka të hapur llogari individuale email dhe mundësi aksesit me fjalëkalime individuale, për të gjithë stafin pedagogjik të programit, studentët dhe stafin mbështetës. Sipas informacioneve të dhëna në RVB dhe nga intervistat në institucion, grupit të vlerësimit të jashtëm iu shpjegua se ky sistem përfshinte të gjitha notat, lëndët, vlerësimet, dhe komunikimet e nevojshme të stafit pedagogjik me studentët si dhe komunikimet e këtyre të fundit me departamentet mbështetëse në institucion. <i>Evidenca nr. 83 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Siç përshkruhet në shtojcën tabela nr. 17, institucioni ka të integruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit edhe platformën beder.edu.al, e cila u ofron të gjithë përdoruesve llogari e-mail me përdorim gjatë kohës së studimit me adresë emermbiemer@beder.edu.al. Gjithashtu platforma https://bis.beder.edu.al/login është krijuar posaçërisht për mësimdhënien dhe raportim online. Platforma mundëson jo vetëm shkëmbimin e informacionit me studentët përsa i përket përmbajtjes së lëndëve dhe orëve të mësimi, por edhe ruajtjen e detyrave të studentëve, dorëzimin dhe vlerësimin. Ndërkohë nëpërmjet platformës BIS, menaxhohet gjithë sistemi i të dhënave të studentëve, që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve të tyre. Për personelin gjithashtu bëhet e mundur menaxhimi i dokumentacionit që prej fillimit të marrëdhënies së punës e deri në përfundimin e kontratës, së tyre. Një platformë shumë e përdorshme në komunikimin interaktiv mes pedagogëve dhe studentëve është edhe Google Classroom tek e cila mund të hyhet nëpërmjet e-mail të hapur në KU Bedër.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit BIS mundëson marrjen e të dhënave në kohë reale për të gjithë studentët, progresin e tyre, si dhe procedurat e nevojshme financiare dhe administrative.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	Institucioni ka informacion të nevojshëm dhe konkret në faqen elektronike https://www.beder.edu.al/ e cila është lehtësisht e aksesueshme. Informacioni në faqe ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, dhe përmban gjithë informacionet për programet

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	e studimit, aktivitetet e institucionit, stafit akademik, departamenteve të tjera mbështetëse etj. Nga një kontroll i thjeshtë i faqes (aksesuar më datë 20 mars 2025), vihet re informacioni mbi programet mësimore, orarin mësimor, kalendarin akademik, si edhe informacionet për kriteret e pranimit, si edhe informacione për klubet studentore, etj. <i>Evidenca nr. 83 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i> <i>Web page: https://www.beder.edu.al/</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU "Bedër" disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional BIS dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Mbështetur në RVB dhe në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se KU "Bedër" bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare. Të dhënat e paraqitura në tabelën 18 në Shtojcë i përkasin institucionit dhe dokumenti tjetër jep planifikimin e Buxhetit specifikisht për Departamentin e Shkencave të Komunikimit. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat 18 - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit</i> <i>Evidenca nr. 1 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 54 Projekt-Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen	Në dokumentin e planifikimit të buxhetit për Departamentin e Shkencave të Komunikimit janë të përcaktuar zërat si tek të ardhurat, ashtu edhe të shpenzimet. Plani i financimit të Departamentit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzime të tjera mbështetëse, shpenzimet për kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në evente/konferenca/seminare. Po ashtu në krahun e të ardhurave përmban si grantet ashtu edhe ato të ardhura nga projektet, konferencat, etj.

e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Evidenca Shtojca – Tabelat 18 - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit Evidenca nr. 54 Projekt-Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas Nenit 1 të Statutit Kolegji Universitar “Bedër” është një person juridik jofitimprurës me karakter ndërkombëtar. Sipas dokumentacionit, KU “Bedër” kryen auditim të rregullt. Dokumenti i përcjellë është auditimi i brendshëm i kryer në institucion për periudhën 1 nëntor 2021 deri në 3 maj 2024. Sipas RVB, një kontabilist i miratuar harton një raport të situatës financiare në mënyrë periodike vjetore, i cili ruhet pranë Fondacionit “Hafiz Ali Korça”. Evidenca Shtojca – Tabelat 18 - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit Evidenca nr. 1 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Evidenca nr. 58 Raporti i Auditimit të Brendshëm
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sikurse përshkruhet në RVB, raportet dhe analizat financiare dhe monitorimi i treguesve financiarë realizohet nga fondacioni pjesë e të cilit është edhe KU “Bedër”. Në fund të çdo viti akademik KU “Bedër” i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Raportin Vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar si edhe parashikimi për buxhetin e vitit të ardhshëm.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni mbi të ardhurat e pasqyruara në Shtojcën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm/Tabelave përmbledhëse rezulton shifra të ardhurash që sigurohen nga këto burime kryesore: • Tarifat e shkollimit; • Donacione, aktivitetet sigurorese dhe fondacionet; • Grantet për kërkimin shkencor dhe kontratat; • Konsulencat dhe shërbimet. Nga raporti i RVB në vitet 2021-2024 institucioni ka pasur rritje graduale të të ardhurave pothuajse në të gjitha zërat, ku



të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	rritja me e lehtë është në tarifat e shkollimit dhe rritja më e madhe është në konsulentat dhe shërbimet. Shifrat e paraqitura në evidenca për periudhat e mëparshme dhe RVB tregojnë për qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Është e rëndësishme të konsiderohet diversifikimi i burimeve financiare, për të eliminuar luhatjet që mund të kenë në buxhetin e institucionit të ardhurat që vijnë nga donacionet/fondacionet dhe aktivitetet e tjera.			
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ vëren se KU "Bedër" ka burime njerëzore të kualifikuara me eksperiencë të cilësuar akademike, të përshtatshme për programin e studimit. Ai ka një godinë dhe infrastrukturë mjedisore të përshtatshme që e pajis mjaft mirë studentin me kushtet për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe me standarde. IAL bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare duke ndjekur disa procedura. Institucioni në statusin e tij është një person juridik jofitimprurës me karakter ndërkombëtar dhe bazohet në katër grupe të mëdha të të ardhurave si (i) Tarifat e shkollimit; (ii) Donacione, aktivitetet sigurose dhe fondacionet; (iii) Grantet për kërkimin shkencor dhe kontratat; sie dhe (iv) Konsulentat dhe shërbimet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika	Institucioni zbaton politika për ciklin e plotë akademik për studentët, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e

dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në evidencat e sjella nga KU “Bedër”, rregulloret e hartuara dhe RVB, vlerësohet se institucioni ka hartuar politika të qarta për pranimin e studentëve, mënyrën e pranimit, vlerësimin, matjen e performancës dhe të tjera kritere që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve për programin, nga hyrja e studentëve në program deri në përfundim të ciklit. Të gjitha këto janë specifikuar në rregulloret si më poshtë: <i>Evidenca nr. 2 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr. 6 Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Pare</i> <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat e hartuara nga institucioni, për të gjithë ciklin e studimit, për të gjithë studentët, siç paraqiten në evidencën nr.6 dhe nr.7, janë jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu institucioni ka në politika të përcaktuar edhe dy kategori si kategori të veçanta: Neni 33 dhe Neni 34 “Personat me aftësi ndryshe” dhe “Studentët me aftësi ndryshe”, në rregulloren e studimeve të ciklit të parë. <i>Evidenca nr. 6 Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Pare</i> <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni harton dhe publikon kriteret për pranimin e studentëve të rinj, përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara dhe të përfshira edhe në Rregulloren e programit (Evidenca nr.7). Kriteret janë të përcaktuar bazuar edhe në bazën ligjore të aprovuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të lidhura edhe me Maturën Shtetërore. Këto kritere publikohen edhe në faqen online të Bedër. Sipas praktikave të njohura edhe nga Ministria e Arsimit, KU “Bedër” bashkëpunon edhe me drejtorisë arsimore rajonale dhe institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të promovuar programet e saj të studimit dhe nxitur pjesëmarrjen/regjistrimin në këto programe. <i>Evidenca nr. 6 Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Pare</i> <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi</i>



	Evidenca nr. 37 Rregullorja e Fakultetit te Shkencave Humane dhe Drejtësisë Evidenca nr. 41 Plani Strategjik Institucional KU Bedër 2024-2028 Evidenca nr. 45 Praktika e Ndjekur per miratim te kriterëve te pranimit te studentëve
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni ka të mirëpërcaktuara rregulloret dhe politikat në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve, përparimin e tyre vlerësimet dhe transferimet. Transferimi i studentëve është i përcaktuar Institucioni në rregulloren përkatëse (evidenca 67) dhe jep të përcaktuara kushtet që duhen plotësuar si edhe proceset administrative, organi vendimmarrës që merret me transferimet. Procedura fillon nga departamenti përkatës dhe vendimi përfundimtar është i një komisioni <i>ad-hoc</i> të ngritur për këtë qëllim. Të dhënat për këto kriterë janë të pasqyruara edhe në faqen online të institucionit https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca nr. 45 Praktika e Ndjekur per miratim te kriterëve te pranimit te studentëve Evidenca nr. 67 Rregullorja e transferimeve
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas informacionit të përcjellë nga RVB dhe dokumentacionit përkatës, KU “Bedër” e bën informimin e publikut për ofertën për këtë program studimi nëpërmjet dy mënyrave: - Publikimit të informacioneve në faqen online - Pjesëmarrja në panairët arsim dhe karrierë, rajonale/lokale që zhvillohen në fillim të çdo viti akademik, si edhe takimet/vizitat me shkollat e mesme. Faqja web: https://www.beder.edu.al/pranimet/programet
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” ka politika të përcaktuara edhe kategori të veçanta, Neni 34 “Studentët me aftësi ndryshe”, në rregulloren e studimeve të ciklit të parë. Gjithashtu institucioni ka të përcaktuar edhe mundësi për të dhënë bursa të veçanta për studentë nga grupe të marginalizuara. Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	KU “Bedër” harton dhe publikon në faqen web edhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve nga shtete të tjera. Neni 32 i rregullores së këtij program studimi paraqet procedurat për

kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	studentët e dërguar në kuadër të bashkëpunimit me universitetet e huaja. Në nenin 11 të Rregullores së programit të studimit saktësohet që për këtë program gjuha e studimit është gjuha shqipe. Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-online			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi” ka politika të përcaktuara në Nenin 36 “Studentët që përfitojnë zbritje nga tarifat e studimit”, në rregulloren e studimeve të ciklit të parë. Procedura ka të përcaktuar detyrimet studentore për të përfitur nga këto zbritje tarife. Në faqen web të universitetit janë të përcaktuara edhe kriteret për të përfitur nga Bursat e Ekselencës, Bursat Sociale dhe Bursat e talentit. https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar ne RVB dhe dokumentacionin e përcjellë shprehet se institucioni i përmbush standardin plotësisht dhe se KU “Bedër” harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Informacionet janë të publikuar në faqen web online si edhe të përshkruara qartësisht në rregulloret përkatëse të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të	Institucioni ka disa mënyra nëpërmjet të cilave sigurohet që studentët të marrin informacion të bollshëm përsa i përket kritereve dhe procedurave lidhur me ecurinë akademike dhe



hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	përparimin nga një vit në tjetrin. Informacioni fillon që me javën e orientimit, e cila zhvillohet përpara fillimit të çdo viti akademik. Studentët që morën pjesë në intervistat me grupin e vlerësimit të jashtëm e konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në këtë javë orientimi. Me tej informacioni është i përfshirë edhe në rregulloren e programit të studimit. <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Guida e Studentit është një dokument i plotë dhe informues mbi informacionet praktike që i duhen studentit. Po ashtu rregullorja e programit të studimit ka të saktësuar edhe kriteret e nevojshme për transferimin e studimeve. Si dokument i veçantë rregullorja e transferimeve përmban gjithë informacionin e nevojshëm për studentët lidhur me njohjen e krediteve/kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme. <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 67 Rregullorja e transferimeve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni nëpërmjet mënyrave të përmendura më sipër vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacion të posaçëm për modulet, lëndët dhe veprimtaritë e ndryshme. Brenda secilit nga syllabuset e lëndëve janë të përshkruara edhe mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve. Përveç “Guidës së studentit”, studentët kanë mundësinë të aksesojnë info për çdo lëndë nëpërmjet sistemit BIS, si edhe në kontakt me sekretarinë. Gjithashtu, ditët e orientimit i ndihmojnë studentët të marrin informacione të veçanta, për studimet e tyre. <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 77 Sylabus-et e lendeve te programit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret e punimit të diplomës janë në dispozicion të studentëve si nëpërmjet informacionin dhe dokumentacion të posaçëm (evidenca 30) ashtu edhe nëpërmjet “Guidës së studentit” (e cila jep informacion më të përgjithshëm) Gjithashtu nëpërmjet rregullores së programit të studimit dhe sistemit BIS, studentët marrin informacionin lidhur me ecurinë e studimeve të tyre deri në diplomim.

	<i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 30 Manuali per pergatitjen se diplomes per studentet e ciklit te pare</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	KU “Bedër” mban kontakte me drejtoritë rajonale arsimore përmes panairove të edukimit dhe karrierës në nivel rajonal dhe qytetesh. Faqja web e institucionit përditësohet me informacionet në mënyrë që të promovohen programet e studimit dhe mundësitë e regjistrimit edhe në formë online. Institucioni gjithashtu publikon broshura dhe fletëpalosje për të promovuar programet e studimit. <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 77 Syllabus-et e lendeve te programit</i> https://www.beder.edu.al/pranimet/studimet-ne-beder https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimet			
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni GVJ vëren se KU “Bedër” vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni nëpërmjet disa mënyrave vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacion të posaçëm për organizimin, kohëzgjatjen, modulet, lëndët të këtij programi studimi. Informacioni jepet në javën orientuese, në syllabuset e lëndëve, në broshurat dhe publikimet e tjera dhe në takimet e drejtpërdrejta me stafin dhe personelin akademik të programit të studimit. Përveç “Guidës së studentit”, studentët kanë mundësinë të aksesojnë info edhe nëpërmjet sistemit BIS, si edhe në kontakt me sekretarinë.

	Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët që prej momentit të këshillimit akademik dhe regjistrimit në programin e studimit marrin informacion për programin e lëndëve. Më pas në javën e orientimit dhe me informacionin nga sekretaria mësimore dhe takimi me pedagogët ata marrin syllabuset e lëndëve, me informacion të plotë për mënyrën se si janë organizuar lëndët, modulet mësimore e veprimtaritë formuese. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën në orë mësimore, literaturë e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve, etj. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ku zhvillohet ky program studimi informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për aktivitetin mësimor. Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca nr. 20 Guida e Studentit. Evidenca nr. 77 Syllabus-et e lendeve te programit
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informacioni për tregun e punës jepet në disa forma. Një ndër to është informacioni i përcjellë nga Zyra e Planifikimit të Karrierës. Edhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit përcjell informacione mbi kërkesat nga tregu i punës. Departamenti dhe Zyra janë mjaft të përfshira në procesin e asistencës për punësimin e studentëve. Një përfaqësues i Departament zgjidhet si përfaqësues pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës. Roli i Këshilltarit lidhet edhe me organizimin e seminareve për shkrimin e cv, praktikimin e intervistave te punës, etj. Sikurse u mësua edhe gjatë vizitës në KU “Bedër” studentët u shprehën për mundësitë që u ofron institucioni nëpërmjet kontakteve me media të ndryshme dhe si kanë ndihmuar ato në vendosjen e lidhjeve dhe punësimet e pjesshme ose të plota gjatë dhe pas mbarimit të studimeve. Evidenca nr. 9 Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfaqesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres.pdf https://www.beder.edu.al/jeta-ne-beder/zyra-e-karrieres
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin	Informacioni i studentëve lidhur me programin e studimit jepet në forma të ndryshme. (Me nënshkrimin e kontratës së studimit në program, nëpërmjet broshurës së programeve Bachelor, nëpërmjet sistemit të komunikimit online, si edhe me

dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	sekretarinë mësimore). Në ditët e orientimit, secila nga Zyrat e KU "Bedër" organizon prezantimin e aktivitetit të saj në ndihmë të studentëve. Menjëherë pas regjistrimit në program studentet asistohen nga zyra e IT të krijojnë llogarinë e tyre të email dhe mundësinë e aksesit në BIS për të marrë gjithë informacionin e nevojshme. Kjo platformë krijon mundësinë edhe të komunikimit me pedagogët në distancë. Sistemi është mjaft i përdorshëm për studentët për dhënien e informacionit lidhur me kalendarin akademik, procesin mësimor, aktivitetet ekstrakurrikulare, etj. Studentët kanë në dispozicion edhe Bibliotekën që është e pajisur si me titujt fizike të librave, ashtu edhe me mundësinë e aksesit online. <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 53 Programi i diteve të orientimit</i> <i>Evidenca nr. 77 Syllabus-et e lendeve të programit</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit mundëson lidhjen e studentëve me pedagogët, departamentin dhe njësitë e tjera administrative në KU "Bedër". Të gjithë studentët dhe pedagogët kanë llogarinë e tyre për të komunikuar online. Sistemi ka të gjithë informacionin për programin e studimit specifik. <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi</i> <i>Evidenca nr. 20 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 77 Syllabus-et e lendeve të programit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se KU "Bedër" vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit, në përputhje të plotë me standardin. Ky informacion përcillet si në formatin e shkruar, fletëpalosje broshura, nëpërmjet takimeve me personelin akademik dhe ndihmës, ashtu edhe nëpërmjet sistemit BIS dhe llogarisë personale e-mail që studentët hapin fill pas procesit të regjistrimit. Këto mjete i ndihmojnë ata të komunikojnë edhe në distancë me pedagogët dhe personelin mbështetës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Në Sekretarinë Mësimore të KU “Bedër” gjenden informacione të plota për statistikën e studentëve në hyrje dhe në dalje për secilin fakultet dhe program studimi. Edhe gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore u njohën me mënyrën e mbajtjes së informacionit dhe ruajtjen e tij sipas rregulloreve.

Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej
2022-2023	6	-	6
2023-2024	-	-	-
2024-2025	-	-	-

Dokumenti “Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve” jep informacione për studentët në vitin 2022-2023 për cilësinë e tyre në fillim të programit të studimit e cila ishte 8.2 në programin e studimit “Shkenca komunikimi”.

Sekretaria mësimore, me anë të regjistrave të saj, ka statistikën e studentëve të regjistruar në programin e studimit, rezultatet e provimeve, lëvizjet, largimet, cilësinë e studentëve në hyrje, etj. Programi i studimit është riorganizuar në “Gazetari dhe komunikim multimedial”. Në këtë program pritet të diplomohen 13 studentë.

RVB BCH Shkenca Komunikimi - Shtojca

Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Sekretaria Mësimore në KU “Bedër” disponon statistikën e programit të studimit “Shkenca Komunikimi”

Viti akademik	Studentë të diplomuar
2022-2023	13
2023-2024	10
2024-2025	-

RVB BCH Shkenca Komunikimi - Shtojca

Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve

Evidenca plotësuese të marra gjatë vizitës në KU Bedër
Evidenca nr. 56 Raport i zyres se te diplomuarve

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Sekretarinë Mësimore, gjendet dosja e çdo studenti me informacionin e duhur, më të dhënat e rezultateve në provime dhe ecurinë vit pas viti. Ky informacion është i ruajtur edhe në sistemin elektronik, si edhe në regjistrat e depozituar në sekretarinë mësimore. GVJ u njoh me këto regjistra gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca nr. 83 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	KU “Bedër” e mbështet veprimtarinë e tij në një bazë rregullative rregulloresh dhe aktesh administrative të miratuara nga Senati Akademik, Rektorati dhe Bordi i Administrimit. <i>Evidenca nr 63 Rregullorja e Arkives</i> <i>Evidenca nr 66 Rregullorja e sekretarise mesimore</i> <i>Evidenca nr. 83 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	KU “Bedër” dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit ndjekin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e studentëve në hyrje të programit dhe në dalje të tij. Raportet e hartuara shërbejnë për zhvillimin e ecurinë e punës më tej. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh edhe me komunikimet e pedagogeve me studentët dhe orientimin që ata bëjnë për cilësinë dhe ecurinë e studimeve të tyre.
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionin plotësues të marrë gjatë vizitës në KU “Bedër”, GVJ vlerëson se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna mbi numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i KU “Bedër” përcakton që në përbërjen e organeve drejtuese ku vihet re edhe prania e studentëve. Në Nenin 10, përbërja e Senatit Akademik është e saktësuar se studentët janë pjesë e Senatit Akademik. Studentët janë të përfaqësuar edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Mendimi i studentëve merret edhe në mbledhjet e Këshillit të Departamentit apo fakultetit ku ngrihen edhe çështje që përcillen nga vetë studentët. Gjithashtu, me një vendim të Senatit të marrë që në vitin 2015, studentët janë të përfshirë në Këshillat e Fakultetit. <i>Evidenca 1. Statuti i KU Bedër</i> <i>Evidenca nr. 68 Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në keshillin e departamentit dhe keshillat e fakulteteve.</i> <i>Evidenca nr. 74 Zgjedhjet e Keshillit Studentor</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përveç bazës rregullative që siguron përfshirjen e studentëve në disa organe të rëndësishme të drejtimit të KU “Bedër”, institucioni ka ngritur edhe pozicionin e Dekanit të Studentëve, i cili siguron mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Sikurse lexohet edhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit në vite, përfshirja e studentëve /përfaqësuesve të tyre është konkrete në tematikë dhe në proceset e ndryshimeve dhe zgjidhjeve. <i>Evidenca nr. 52 Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjelle nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve</i> <i>Evidenca nr. 59 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2022-2023</i> <i>Evidenca nr. 60 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 74 Zgjedhjet e Keshillit Studentor</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Sikurse përshkruhet në RVB dhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit studentët janë të përfshirë në disa forma në punën e departamentit. Kjo realizohet si me anën e pyetësorëve të ndryshëm për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit. Anketimet përfshijnë vlerësimin anonim të studenteve për programin, lëndën pedagogun dhe institucionin. Vlerësimi edhe i metodave të mësimdhënies shihet në çdo anketim dhe i shërben përmirësimit të tyre dhe përshtatjes me të nxëniet sa më të mirë të studentëve. Në pyetësor ruhet anonimati i studentëve. Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën për mundësitë që u ofron universiteti në diskutime dhe kontakte të afërta me pedagogët dhe departamentin dhe u evidentuan si shembull lëndët e lidhura me krijim dhe zbatimin e fushatave publicitare të tilla si “Planeti nuk është tavllë” si edhe krijimi gjatë kohës së Pandemisë së Covid 19 të startup si “dritare e mundësive”. <i>Evidenca nr. 11 Ankete Vlerësimi e Mendimit të Studenteve ndaj Institucionit</i> <i>Evidenca nr. 12 Ankete Vlerësimi i Studenteve për Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 13 Ankete Vlerësimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 14 Ankete Vlerësuese për Lënden dhe Pedagogun nga Studentet</i> <i>Evidenca nr. 52 Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjelle nga studentet dhe ku kanë qenë prezent perfaqësues të studenteve</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e brendshme të universitetit si edhe rregullorja specifike e programit të studimit Bachelor “Shkenca Komunikimi” përcakton edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më konkretisht mënyra e vlerësimit është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. Në fund të çdo semestri, studentët nëpërmjet pyetësorëve shprehin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit. Gjithashtu, KU “Bedër” ka edhe një të miratuar edhe procedurën e ankimit të notës. Në rastet e paraqitura të ankimit të notës, shihet formulari i cili përmban edhe arsyet se pse studentët e bëjnë këtë ankimim të notës. Më pas procedura përfshin edhe ngritjen e komisionit për



	rishikimin/rivlerësimin e notës dhe deri edhe në relacionin përfundimtar të komisionit për ndryshimin ose jo të notës. Në shembuj e paraqitur, ankesat e studenteve lidhen më shumë me “gabime matematikore ose teknike” në vlerësim dhe më pas komisioni i ka ndryshuar këto vlerësime. <i>Evidenca nr. 47 Rast ankimim note</i> <i>Evidenca nr. 48 Procedura e Ankimimit te Notes</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët, GVJ vlerëson se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Kjo është e përshkruar jo vetëm në bazën rregullative të institucionit (statute, rregullore dhe proceduara por edhe në zbatimin praktik të tyre. Mendimet e studentëve merren nga përfshirja e tyre në organe vendimmarrëse përmes Këshillave studentore, por edhe nëpërmjet pyetësorëve të ndryshëm. Gjithashtu me dokumentacionin e përcjellë institucioni ka të garantuar edhe mundësinë e rishikimit dhe ankimimit të notës për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ gjykon se KU “Bedër” ka procedura dhe zyra specifike për t’i shërbyer sa më mirë studentëve, bazuar edhe në aktet ligjore dhe rregullatore. Disa nga zyrat e posaçme të KU “Bedër” janë Zyra e Këshilltarit Akademik, Dekani i studentëve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Planifikimit të karrierës së Studentëve janë në shërbim të studentëve jo thjesht për informacion, por edhe për ti mbështetur në përzgjedhjet e tyre akademike. Institucioni ka në shërbim të informimit në distancë edhe sistemin BIS të përshkruar më lart. <i>Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i>

	Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca nr. 22 Vendimi i Keshillit te Departamentit per Caktimin e Koordinatorëve te Programeve te Studimit Evidenca nr. 23 Vendimi i keshillit te Departamentit per Caktimin e Keshilltareve Akademike Evidenca nr. 66 Rregullorja e sekretarise mesimore
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i informimit të studentëve në KU “Bedër” ka në themel të tij Këshilltarin Akademik dhe ngritjen e Zyrës së Planifikimit të Karrierës. Informimi nis që me ditët e orientimit për të vijuar më pas gjatë të gjithë vitit akademik me këshillimet dhe plotësimet me informacione të ndryshme. Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Evidenca nr. 5 Rregullorja e Fakultetit te Shkencave Humane dhe Drejtësisë Evidenca nr. 6 Rregullorja e Studimeve te Ciklit te Pare Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit te studimit Bachelor ne Shkenca Komunikimi Evidenca nr. 9 Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfaqesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Planifikimit të Karrierës është në funksion pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, pranë së cilës emërohet një Këshilltar nga çdo departament. Kjo zyrë i ndihmon studentët edhe në drejtim të aplikimeve për kurse trajnimi dhe përfshirjes në projekte të ndryshme, ashtu edhe për trajnime online dhe për praktikën. Funksioni i saj parësor është këshillimi gjatë kohëzgjatjes së procesit akademik të studentëve në të gjitha etapat deri në diplomim. Evidenca nr. 9 Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfaqesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres Evidenca nr. 59 Raporti vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit, 2022-2023 Evidenca nr. 60 Raporti vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit, 2023-2024
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna	Zyra e Planifikimit të Karrierës bashkëpunon me njësitë e tjera administrative dhe sidomos me zyrën e të Diplomuarve si edhe mbledh dhe përpunon edhe të dhënat e studentëve pas diplomimit.

mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në faqen zyrtare online të universitetit https://www.beder.edu.al/jeta-ne-beder/zyra-e-karrieres ka informacione plotësuese për studentët dhe klubet e tyre. Në raportin vjetor të ndërtuar nga zyra e të diplomuarve jepen të dhëna edhe për shkallën e punësimit të studentëve.			
Konkluzione	<i>Evidenca nr. 56 Raport i zyrës së të diplomuarve</i> <i>GVJ vlerëson se KU "Bedër" ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni dhe atë të marrë gjatë vizitës në universitet, GVJ gjykon se KU "Bedër" ka rregullore të brendshme dhe një udhëzim, dokumente këto të cilat evidentojnë mënyrat e mësimdhënies për t'i shërbyer sa më mirë të nxënit të studentëve. Eksperienca e viteve 2020 me pandeminë Covid 19 i ka vënë në kërkim të formave të reja të mësimdhënies, nëpërmjet Google classroom, përdorim që vijon edhe pas kalimit të periudhës së pandemisë. Pedagogët në këtë program studimi, gjatë vizitës u shprehen se atyre u janë bërë trajnime dhe i përdorin këto forma edhe në module të ndryshme mësimore. Udhëzimi mbi mësimdhënie në distancë i datës 24/03/2020 shpjegon të gjithë procesin, metodat e mësimdhënies në distancë, procedurat e vlerësimit, format e provimit të njohurive, mënyrat e arkivimit të detyrave dhe provimeve ankimimin ndaj rezultateve të provimeve etj.

	Evidenca nr. 84 <i>Udhëzuesi për Mesimdhënien Inovative</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	“Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve” është ndërtuar në vitin 2012 dhe e përditësuar në vijimësi. KU “Bedër” ka ndërtuar Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit. Ky është një organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimit. Rregullorja për funksionimin e tij është e përditësuar në vitin 2019. Ky komision “nxjerr urdhër dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, NJSBC, në KU “Bedër” është krijuar bazuar në Statutin dhe Rregullores së Organizimit të Brendshëm të institucionit. NJSBC është organizmi kryesor përgjegjës “... për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollin periodik dhe ndjekjen e tyre në institucion.” Kjo njësi bashkëpunon me të gjitha fakultetet dhe njësitë bazë dhe harton çdo vit një plan/kalendar të vlerësimit semestral ku janë të përcaktuar monitorimet. Sipas rregullore përkatëse të hartuar që prej viti 2014 dhe përditësuar në vijim, institucioni përdor disa formate vlerësues për pedagogun dhe lëndën. Ky vlerësim bëhet çdo semestër dhe plotësohet nga autoriteti drejtues si edhe një anëtar i NJSBC. Rregullorja ka të përcaktuar edhe detyrat dhe kompetencat e NJSBC. Pranë kësaj njësie, në varësi të nevojave mund të krijohen edhe komisione <i>ad-hoc</i> Evidenca nr. 51 <i>Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</i> Evidenca nr. 65 <i>Rregullorja e Funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit</i> Evidenca nr. 72 <i>Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Në përbërje të NJSBC dhe grupet e vlerësimit të cilësisë dhe monitorimit të brendshëm përfshihen anëtarë të njësive bazë, një përfaqësues i Këshillit Studentor si edhe një ekspert i jashtëm. Studentët janë të përfshirë në vlerësimin e metodave të mesimdhënies dhe vlerësimit të dijes edhe nëpërmjet pyetësorëve semestralë për pedagogun dhe lëndën.

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët e kanë të garantuar edhe mundësinë e ankimit të notës dhe KU “Bedër” ka nxjerrë një procedurë si vepohet për ankimin e notës. (Me hollësisht në pikën V.5.4) <i>Evidenca nr. 47 Rast ankimim note</i> <i>Evidenca nr. 48 Procedura e Ankimimit te Notes</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit si edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar në rregulloret përkatëse bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. Raportet periodike mbi vrojtimit, monitorimet u dërgohen strukturave drejtuese të KU “Bedër”, por gjithashtu edhe pedagogëve sipas lëndëve përkatëse, si edhe drejtuesve të njësive bazë. Raportet janë edhe pjesë e diskutimeve në nivel dekanati për përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies në institucion. Vlerësimet janë pjesë edhe e dosjes personale të pedagogut. Në faqen online të institucionit jepet baza rregullative për kontrollin e brendshëm të cilësisë. https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf Gjithashtu janë të publikuara edhe raportet dhe vendimet lidhur me këto kontrole. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni ka të hartuar procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve që ofron. Diskutimet për përmirësimin e mësimdhënies, si edhe evidentimi i praktikave më të mira zhvillohen në nivel departamenti. Kjo i ndihmon pedagogët të shkëmbejnë praktikatat e tyre bazuar edhe në përvoja të ngjashme brenda departamenteve. <i>Evidenca nr. 57 Raport Permbledhes Vleresimi i Departamentit per Stafin</i> <i>Evidenca nr. 59 Raporti vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit, 2022 2023</i> <i>Evidenca nr. 60 Raporti vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit, 2023 2024</i>
Konkluzione	Bazuar në informacionin e grumbulluar dokumentuar dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se KU “Bedër” ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të

	Cilësisë ka zhvilluar mekanizma të qartë monitorimi, ku janë të përfshirë edhe studentët dhe rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen edhe publike nëpërmjet raporteve edhe në faqen online të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Mbështetur në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë” KU “Bedër” ka ndërtuar një bazë rregullatore dhe një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë. 1. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit; 2. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Komisioni i Përhershëm është një organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimit. Rregullorja për funksionimin e tij thekson se ky komision “... nxjerr urdhëra dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, NJSBC ka rregulloren e saj të veçantë të funksionimit. Krahas detyrave të saj të përcaktuara qartësisht në këtë rregullore, pranë kësaj njësie mund të ngihen edhe grupe “grupet <i>ad-hoc</i>”, për vlerësimin e stafit akademik, etj. Gjithashtu institucioni ka ndërtuar edhe udhëzimin për procesin e zhvillimit të kurrikulave, që janë të gjitha në funksion të përsosjes së procesit të mësimdhënies. <i>Evidenca nr. 51 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</i> <i>Evidenca nr. 65 Rregullorja e Funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf <i>Evidenca nr. 81 Udhëzim mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës</i>

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar (siç u listua më sipër), KU “Bedër” ka ngritur NJSBC me objektiv themelor monitorimin dhe ruajtjen e brendshme të cilësisë. Në “Rregullore për funksionimin dhe organizimin e NJSBC” është mirëpërcaktuar se cilët janë anëtarë të kësaj njësie. Janë pesë anëtarë dhe një përfaqësues nga këshilli Studentor dhe një Ekspert i jashtëm. Institucioni ka hartuar një Plan strategjik 2024-2028 ku cilësia është një ndër kapitujt e veçantë të tij. Ndër objektivat specifike të lidhur me cilësinë veçojmë: Objektivat e veçanta 1. <i>Rritje e cilësisë së programeve të studimit, përmirësim i infrastrukturës akademike dhe zbatim i standardeve të larta të vlerësimit institucional, me qëllim nxitjen e një kulture të vazhdueshme vlerësimi të qëndrueshëm, mendimi kritik dhe aftësi praktike në mësimdhënie, duke u vatëruar te studenti.”</i> Objektivat e veçanta 6. <i>Kualifikim, trajnim dhe mbështetje e vazhdueshme e stafit me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, avancimin institucional dhe promovimin në karrierë të stafit.</i> <i>Evidenca nr. 1 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf <i>Evidenca nr. 40 Plani Strategjik Institucional i KU Bedër, 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 41 Plani Strategjik Institucional KU Bedër 2024-2028</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	Sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, siç janë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm. Ndër instrumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë përmendim monitorimet, anketimet, dhe bashkëpunimet me ekspertë të jashtëm. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL. Raportet e Vlerësimit institucional nga agjencitë e ndryshme të akreditimit janë të publikuara në faqen web të institucionit. KU “Bedër” bën në mënyrë periodike akreditime të jashtme të programeve të studimit si edhe akreditim institucional. Akreditimi me i fundit institucional është nga ASCAL në 2021. https://qac.beder.edu.al/files/Raporti-i-vleresimit-te-jashtem-institucional-2021.pdf

cilësinë në programin e studimit.				
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni ka të zhvilluara një sërë formash anketimi të cilat e masin cilësinë e programeve nëpërmjet disa pikëpamjeve: atë të studentëve, stafit pedagogjik dhe stafit administrative. Këto instrumente janë të hartuara dhe miratuara, ndërkohe që përmbajtja e tyre rishikohet, herë pas here. Treguesit e përdorur për matjen e mësimdhënies dhe aktiviteteve kërkimore janë të përcaktuar në dokumenta dhe rregullore të hartuara nga KU "Bedër". Gjithashtu edhe Plani Strategjik Institucional 2024-2028 ka të përcaktuar një seksion specifik për cilësinë. Universiteti ka ndërtuar procedura pune me lidhur me anketimet dhe monitorimet. <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/cilesia <i>Evidenca nr. 41 Plani Strategjik Institucional KU Bedër 2024-2028</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se KU "Bedër" harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Baza rregullatore mjaft e plotë dhe e përditësuar si edhe mekanizmat e ndërtuar për këtë qëllim janë plotësisht efektivë për të matur e siguruar cilësinë e programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të	Institucioni ka Njësine për Sigurimin e Cilësisë e cila është e angazhuar për vlerësimin e dy komponentëve të programit në mënyrë periodike: cilësinë e stafit akademik dhe të lëndëve sipas programeve të studimit. Këto dy vlerësime bëhen në fund të semestrit, pasi lënda është ofruar për studentët. Gjetjet që dalin nga

dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	këto procese anketimi, raportohen tek Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës, për përshtatje të elementeve që kanë të bëjnë me kurrikulës. Ndërkohë çështjet që lidhen me stafin akademik, adresohen në departament. Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është në rang institucioni, pra e njëtrajtësuar. (Ndryshimet qëndrojnë në objektivat e programeve të studimit apo shkallët krahasuese, por metodologjia dhe instrumentet e përdorura janë të njëjta.) Evidenca nr. 62 Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Metodat e vlerësimit të përdorura për matjen e cilësisë në këtë program janë disa pyetësorë/anketime të cilat e matin performancën e programit nga disa këndvështrime: e studentëve, e stafit pedagogjik, si edhe e stafit administrativ. Përveç këtyre teknikave formale të matjes, studentët mund edhe të komunikojnë dhe shprehin shqetësimet e tyre pranë zyrave që janë në shërbim të tyre si p.sh. ajo e sekretarisë mësimore, këshillimit të karrierës, dekani i studentëve etj. Në takimet individuale të drejtuesit të departamentit me pedagogët apo me stafin ndihmës vihen në dukje problematikat si edhe rastet pozitive. Këto dokumentohen si praktikatat e mira edhe në raportet e vlerësimit. Evidenca nr. 59 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2022 2023 Evidenca nr. 60 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023 2024

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës , testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni përdor anketa vlerësimi, nga të gjitha grupet e përfshira në procesin mësimdhënës të tilla si studentët me fokus cilësinë e mësimdhënies, si dhe anketë vetëvlerësimi të pedagogut. Këto janë: 1. Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës; 2. Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit; 3. Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit; 4. Anketa e vlerësimit të studentëve për programin e studimit; 5. Anketa e vlerësimit të të diplomuarëve për programin e studimit. <i>Evidenca nr. 8 Anketa Vleresuese e Stafit Akademik dhe Administrativ ndaj Institucionit</i> <i>Evidenca nr. 11 Ankete Vleresimi e Mendimit te Studenteve ndaj Institucionit</i> <i>Evidenca nr. 12 Ankete Vleresimi i Studenteve per Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 13 Ankete Vleresimi i te Diplomuarve per Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 14 Ankete Vleresuese per Lenden dhe Pedagogun nga Studentet</i> <i>Evidenca nr. 17 Formulari i Vetevleresimit per Stafin Akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre	KU “Bedër” në dokumentin “Politika e Kolegjit Universitar Bedër për Cilësinë” ka të përcaktuar edhe treguesit e rezultateve dhe cilësia e të cilëve përcaktohen nga organet drejtuese te institucionit, që janë: ▪ Cilësia e pranimit të studentëve, ▪ Përparimi dhe suksesi i studentëve, ▪ Cilësia dhe punësimi i të diplomuarëve, ▪ Vlerësimi i kurrikulës, ▪ Cilësia e kërkimit shkencor, ▪ Cilësia e publikimeve shkencore, ▪ Cilësia e shërbimeve të ofruara, ▪ Menaxhimi i financave, ▪ Përdorimi efektiv i burimeve dhe kapaciteteve, ▪ Kënaqësia (gëzimi a lumturia) e studentëve,


të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	▪ Kënaqësia (gëzimi a lumturia) e personelit. Treguesit e rezultateve analizohen dhe vlerësohen nga njësitë përkatëse. Në bazë të rezultateve të arritura planifikohen masat dhe aktivitetet e duhura. Vihet re një fokus i madh tek studentë si target grup për pyetësorët në lidhje me performancën e programit si edhe të pedagogëve. Për stafin pedagogjik instrumentet të tjerë të matjes së cilësisë janë edhe vlerësimi nga vlerësim nga shefi i departamentit që asiston një orë leksioni, dhe komunikimet e problematikave me stafin mes kolegësh, etj. <i>Evidenca nr. 43 Politika e Kolegjit Universitar Bedër per Cilesine</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se KU "Bedër" monitoron dhe vlerëson përmes NJSC në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. Institucioni ka një bazë të plotë rregullatore të aprovuar dhe të përditësuar në vijimësi që ndihmon në monitorimin dhe dokumentimin e vlerësimeve të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar	KU "Bedër" ka të përfshirë si anëtarë në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, një përfaqësues të studentëve, i zgjedhur nga Këshilli Studentor dhe një ekspert të jashtëm. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është operacionale dhe zhvillon rregullisht procese të matjes së cilësisë në institucion duke përfshirë të gjitha grupet e interesit, si: studentë, stafin pedagogjik, stafin administrative. Një rol të rëndësishëm në institucion përsa i përket sigurimit të cilësisë luan edhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë i cili harton politikat dhe monitoron

të cilësisë së programit të studimit.	zbatimin e tyre. Këto struktura kanë përfaqësues nga të dy fakultetet si edhe ekspertë të jashtëm. <i>Evidenca nr. 1 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër</i> <i>Evidenca nr. 43 Politika e Kolegjit Universitar Bedër per Cilësinë</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nga informacioni i përcjellë në formë dokumentare nga KU “Bedër” si edhe nga diskutimi me NJSBC edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion u evidentua se informacionet e mbledhura nga monitorimet tregojnë se aktiviteti mësimor është në përputhje me standardet e vendosura. Instrumentet e marra si të drejtpërdrejta, ashtu edhe pyetësorët kanë sjellë informacione që kanë vlerësuar ecurinë e procesit mësimor. Institucioni i ka të mirëhartuara përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë instancat e përfshira në sigurinë e cilësisë. Ky informacion është i përfshirë dhe artikuluar në Rregulloren e funksionimit të NJSBC. Baza e vlerësimit për stafin akademik është edhe vetëvlerësimi individual. Këtij vlerësimi, duke i shtuar edhe ato periodike të bëra nga NJSBC përdoret në procesin e vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe përpara firmosjes së kontratës vjetore.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në proceset e vlerësimit të cilësisë në institucion ka një gjithë përfshirje të aktorëve të institucionit që përfshijnë: studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ. Njësia bën një koordinim të mirë të punës për mbledhjen dhe shpërndarjen e gjetjeve të proceseve të vlerësimit me njësinë bazë dhe atë kryesore për këtë program studimi.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	Njësia e sigurimit të cilësisë, nëpërmjet hartimit të pyetësorëve dhe plotësimit të tyre në mënyrë anonime dhe ciklike, respekton integritetin akademik dhe shmang procese diskriminuese apo pabarazie mes stafit apo studentëve. Pyetësorët, janë të hartuar në atë mënyrë që masin jo vetëm cilësinë e stafit pedagogjik, por edhe performancën e lëndës. Gjithashtu, pyetësorët përmbajnë edhe indikatorë sasiorë dhe cilësorë, për ta bërë më të plotë matjen.



pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Një nga rrugët e vlerësimit dhe shpërndarjes së eksperiencave pozitive, sikurse përshkruhet edhe në RVB janë analizat vjetore ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe administrativ të cilët shkëmbejnë përvoja dhe japin sugjerime për tematikat e shtruara në këto analiza vjetore. KU “Bedër” ka të miratuar edhe dokumentin “Politikat për barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet” i cili i shërben më së miri shmangies së çdo lloj diskriminimi. <i>Evidenca nr. 59 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2022 2023</i> <i>Evidenca nr. 60 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023 2024</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Siç u përmend më sipër, në Rregulloren Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në institucion, është përcaktuar që një prej anëtarëve të kësaj njësie, të jetë një ekspert i jashtëm dhe anëtari tjetër të jetë një student. Krahas pjesëmarrjes së një eksperti të jashtëm si pjesë e NJSBC, në KU “Bedër” departamentet përkatëse organizojnë takime të shpeshta me përfaqësues të industrisë dhe të të diplomuarve të cilët japin këndvështrime të ndryshme dhe ballafaqojnë tregun me programet mësimore.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se KU “Bedër” garanton procedura të brendshme të ruajtjes dhe rritjes së cilësisë duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë janë dy organizmat që garantojnë cilësinë. Njësia dhe Komisioni, si edhe Senatin Akademik respektojnë integritetin akademik. Në përbërje të NJSBC merr pjesë edhe një përfaqësues i studentëve. Departamentet organizojnë edhe takime me përfaqësues të industrisë dhe të të diplomuarve të cilët japin këndvështrime të ndryshme dhe ballafaqojnë tregun me programet mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe baza rregullatore ku mbështetet aktiviteti i NJSBC në shërbim të rritjes së cilësisë për programet e studimit në të gjithë universitetin janë të miratuara dhe janë publike në faqen online të universitetit. NJSBC harton kalendarin e aktivitetit të saj dhe e përcjell këtë tek rektori për diskutim pas komunikimit edhe me njësitë e tjera në KU "Bedër". Raportet e vlerësimit u njoftohen edhe drejtuesve të departamenteve përkatëse, dhe publikohen në faqen online të dedikuar sigurimit të cilësisë. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen online të KU "Bedër" janë të publikuara rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për programet e studimit. Institucioni i konsideron mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e mësimdhënies në universitet çështjet e etikës dhe lirinë akademike. Disa të dhëna që konsiderohen sensitive lidhur me monitorimin, përcillen tek individët dhe drejtuesi i drejtpërdrejtë, duke ruajtur hierarkinë e vendimmarrjes, por pa çenuar etikën dhe bazën rregullatore në fuqi. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/vendime-te-bordit-te-akreditimit
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ u njoh me llojet e informacioneve të mbledhura në shërbim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Informacioni i mbledhur me të gjitha formatet (anketime, vëzhgime nga kolegët/drejtuesit e departamenteve, në orët e mësimin, etj.) përdoret si për të ndjekur ecurinë e progresit dhe për të zgjidhur problematika që mund të dalin nga sfidat në mësimdhënie dhe nxënie. Rezultatet nga vlerësimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi në rastet kur është e nevojshme. <i>Evidenca nr. 40</i> Plani Strategjik Institucional i KU Bedër, 2018-2023 <i>Evidenca nr. 59</i> Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2022 2023 <i>Evidenca nr. 60</i> Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023 2024

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	KU Bedër i përdor informacionet e marra nga format e ndryshme të vrojtimit për t'i diskutuar me stafin akademik dhe linjat e hierarkisë në përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe mësimdhënies. Planet e punës dhe kalendari i aktiviteteve të NJSBC sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin shumëplanësh të cilësisë në institucion.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Me synim përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në përmirësimin e cilësisë së programeve akademike NJSBC organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për përfshirjen aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm. Studentët janë pjesëmarrës në GVB dhe në organizmat që monitorojnë sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, informacion të rëndësishëm studentët marrin edhe në javën e parë të orientimit lidhur me ecurinë dhe mënyrat për të kontribuar në cilësinë e programeve të studimit.			
Konkluzione	<i>Mbështetur në informacionin e përcjellë dhe të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se UMSH ka politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit, të cilat janë publike, transparente. NJSBC funksionon qartësisht duke ndjekur bazën rregullatore dhe në përbërjen e GVB ka gjithnjë edhe studentë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca komunikimi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar BEDER.”

Pikat e forta dhe afirmime

1. **Stafi akademik i kualifikuar** - Programi mbulohet nga staf akademik me grada shkencore përkatëse dhe me përvojë në fushën e komunikimit. Angazhimi i lektorëve me eksperiencë praktike në media dhe PR rrit vlerën e mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës.
2. **Mbështetja për studentët dhe veprimtaria kërkimore** - Studentët përfitojnë nga mentorimi dhe orientimi akademik gjatë gjithë ciklit të studimeve. Programi inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore dhe pjesëmarrjen në konferenca apo botime shkencore.
3. **Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimet** - Kolegji Universitar Bedër ka lidhje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, duke ofruar mundësi për shkëmbime studentore dhe përvoja ndërkulturore. Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare (seminare, konferenca) kontribuon në zgjerimin e horizonteve akademike dhe profesionale të studentëve.
4. **Infrastruktura e plotë duke përfshirë edhe ateliene e prodhimit mediatik.** Janë tre laboratorë dhe një studio prodhimi të pajisur me software të nevojshëm për median. Edhe prodhimi në redaksinë e “Objektiv.al” vë në praktikë njohuritë e mësuara.
5. **Auditorë të hapur me përfaqësues të kompanive mediatike apo profesionistë sipas programit të studimit.** Departamenti e kishte synim dhe zbatim konkret vendosjen e kontakteve me profesionistët e fushës dhe ftesat në universitet për ta për të folur me studentët.

Pika të dobëta

1. **Rritja e përfshirjes në projekte/network me universitete të tjera ndërkombëtare, duke i shërbyer edhe përfshirjes së teknologjive të reja të komunikimit në kurrikulë** - KU Beder ka arritur të jetë pjesë e disa projekteve ndërkombëtare, por përsëri nevojitet rritja e pjesëmarrjes në këto rrjetëzime të universiteteve ndërkombëtare duke u fokusuar edhe në përdorimin e teknologjive të reja digjitale dhe IA. Këto mund të jenë në formën edhe të seminareve speciale për studentët e këtij programi.
2. **Nevoja për diversifikim të mëtejshëm të burimeve financiare për mbështetjen e programeve të studimit.** – Ndër vite kolegji universitar ka treguar qëndrueshmëri financiare, por vazhdon të jetë e lartë pjesa e buxhetit që vjen nga “donacionet, aktivitetet siguruese dhe fondacionet, etj.” KU Beder duhet të shikojnë mundësitë për të rritur dhe përfshirë të ardhura të tjera në mundësitë financiare.
3. **Promovimi i ulët ndërkombëtar i programit dhe sidomos në trevat shqipfolëse** - KU Beder duhet të forcojë komponentin e marketimit më të fortë të programit duke thithur më tepër studentë nga trevat shqipfolëse. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm



drejt njohjes me të gjerë ndërkombëtarisht, si edhe pjesëmarrjes së studentëve apo pedagogëve të huaj si pjesë e projekteve.

Rekomandime

1. **Promocion dhe marketim i mëtjshëm në trevat shqipfolëse dhe më gjerë** – Kjo do të rrisë numrin e studentëve nga këto treva duke diversifikuar pjesëmarrjen e studentëve.
2. **Rritja e përfshirjes së KU Bedër në projektet e kërkimit shkencor në rrjet më universitetet e tjera.** – Kjo do ti shërbente mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve si edhe shkëmbimit të informacionit për përfshirjen e teknologjive digjitale dhe AI si pjesë e seminareve të veçanta gjatë programit Master i Shkencave.
3. **Diversifikimi i burimeve financiare të KU Bedër për të rritur peshën specifike të të ardhurave të tjera ndaj donacioneve.**

Evaluation's conclusions for the study program Bachelor "Communication Sciences" provided by the Higher Education Institution "Bedër University College"

Strengths and affirmations

1. **Qualified Academic Staff.** The program is covered by academic staff holding relevant scientific degrees and with experience in the field of communication. The involvement of lecturers with practical experience in media and PR adds value to teaching and strengthens the program's link to the job market.
2. **Student Support and Research Activity.** Students benefit from mentoring and academic guidance throughout the entire study cycle. The program encourages student involvement in research projects and participation in conferences and academic publications.
3. **Internationalization and Collaborations.** Bedër University College maintains collaborative links with international universities, offering opportunities for student exchanges and intercultural experiences. The organization of international activities (seminars, conferences) contributes to the expansion of students' academic and professional horizons.
4. **Infrastructure includes not only classes and auditors, but a complete media production studio.** There are three laboratories and a production studio equipped with the necessary software for the multimedia. Including the editorial office of online media "Objektiv.al" where students put into practice the knowledge they get during the program.
5. **Open lectures with representatives of media companies or professionals according to the study program.** The department had its goal the establishment of contacts with professionals in the multimedia field. Media industry professionals were often as guest speaker in the auditors of the university.

Weaknesses

1. **Increasing participation and involvement in international projects/networks with other international universities, to include new communication technologies in the curriculum.** KU Beder has managed to be part of several international projects, but again, there is a need to increase participation in these international university networks by focusing on the use of new digital technologies and AI. These could also be in the form of special seminars for students of this program.
2. **The need for further diversification of financial resources to support study programs.** Over the years, the university college has shown financial stability, but the share of the budget that comes from “donations, insurance activities and foundations, etc.”, continues to be high. KU Beder should search for other opportunities to increase and include other income in financial opportunities.
3. **Low international promotion of the program and especially in Albanian-speaking areas in the nearby countries.** KU Beder should strengthen the marketing component of the program by attracting more students from Albanian-speaking neighbouring countries. This will be an important step towards wider international recognition, as well as the participation of foreign students or lecturers as part of the projects.

Recommendation

1. **Further promotion and marketing in Albanian-speaking neighbouring countries, and more.** This will increase the number of students from these regions by diversifying student participation.
2. **Increasing the involvement of KU Beder in scientific research projects in the network with other universities.** This would serve the mobility of students and lecturers as well as the exchange of information on the inclusion of digital technologies and AI as part of special seminars during the Master of Science program.
3. **Diversifying KU Beder's financial resources to increase the specific weight of other income rather than donations.**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X